



**KOSOVO LOCAL  
GOVERNMENT  
INSTITUTE**

# **RAPORTI I MONITORIMIT TË FINANCIMIT PUBLIK TË OJQ-VE NË NIVEL LOKAL PËR VITIN 2023**

*Prishtinë, janar 2025*

## Përmbajtja:

Përmbledhje Ekzekutive .....	4
Hyrje .....	7
Metodologjia .....	8
Procesi i Monitorimit .....	9
Partnerët .....	9
Kufizimet e hasura gjatë Monitorimit.....	10
<b>VLERËSIMET INDIVIDUALE</b> .....	<b>11</b>
Aspekti Procedural .....	12
Procesi i Vlerësimit dhe Kontraktimi.....	17
Monitorimi dhe Raportimi .....	22
<b>MONITORIMET VJETORE</b> .....	<b>23</b>
Planifikimi i Mbështetjes Financiare.....	23
Mekanizmat e Zbatimit të Procesit.....	25
Raportimi/Monitorimi i komunave .....	27
<b>REZULTATET</b> .....	<b>32</b>
Vlerësimet Individuale .....	32
Monitorimet Vjetore.....	34
Renditja e Komunave bazuar në Përmbushjen e Kriteve nga Monitorimi Individual dhe Vjetor.....	35
Gjetjet e Auditimit Financiar 2023 dhe Rekomandimet 2022 .....	37
Konkluzionet.....	40
Rekomandimet .....	43
<b>ANEKSET</b> .....	<b>47</b>

## Përmbledhje Ekzekutive

Ky dokument pasqyron progresin në përmbushjen e indikatorëve të monitorimit mbi zbatimin e Rregullores nr. 04/2017 për Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve në nivel lokal. Raporti ndjek zbatimin e obligimeve të Rregullores nga komunat në proceset e financimit publik për OJQ-të.

Monitorimi mbulon fazat kryesore: **Planifikimin e Financimit, Aspektin Procedural, Procesin e Vlerësimit dhe Kontraktimit**, si dhe **Monitorimin dhe Raportimin**. Përgjatë periudhës së monitorimit (maj – shtator 2024), janë kryer dy qasje kryesore të vlerësimit: monitorimi individual dhe monitorimi vjetor. **Monitorimi individual** është fokusuar në analizën e thirrjeve të publikuara nga komunat gjatë vitit 2023, ku janë identifikuar dhe analizuar gjithsej 32 thirrje nga 16 komuna, bazuar në treguesit kryesorë të monitorimit. Në anën tjetër, **monitorimi vjetor** ka qenë i përqendruar në vlerësimin e performancës vjetore të komunave dhe kapaciteteve të tyre për zbatimin e financimeve publike. Nga 38 komuna të monitoruara, 22 prej tyre kanë paraqitur planifikimin e financimit publik, por vetëm 19 kanë plotësuar kriteret e nevojshme për t'u përfshirë në këtë analizë.

### Problemet në Ueb-faqet e Komunave

Për të pasqyruar më saktë situatën, duhet theksuar se ueb-faqet zyrtare të komunave vazhdojnë të përballen me probleme të shumta, si në qasje, navigim dhe gjetjen e dokumenteve. Kjo sfidë është evidentuar edhe në Raportin Periodik për Vlerësimin e Transparencës në Komuna për vitin 2023, ku theksohet se zyrat e informimit të komunave kanë pasur vështirësi të mëdha për shkak të mosfunksionimit të rregullt të ueb-faqeve zyrtare. Këto probleme përfshijnë qasjen e kufizuar në ueb-faqe, vonesat në hapjen e dokumenteve, saktësinë e të dhënave dhe ndërprerjet e shpeshta të funksionimit të ueb-faqeve, të cilat shpeshherë bëjnë të pamundur marrjen e informacioneve brenda afateve të përcaktuara. Si rezultat, këto mangësi pengojnë përditësimin e të dhënave dhe funksionimin efektiv të ueb-faqeve, duke ndikuar negativisht në transparencën dhe qasjen e publikut në dokumentet që duhet të jenë të arritshme.

### Mospërputhjet në Planifikim dhe Raportim

Duhet theksuar se ekziston një mospërputhje midis planifikimit të financimit publik për OJQ-të, thirrjeve për financim dhe raportimit gjithëpërfshirës. Nga 38 komuna të monitoruara, 22 kanë paraqitur planifikimin e financimit publik,<sup>1</sup> Sa i përket monitorimit individual (thirrjeve të publikuara), janë nxjerre të dhëna nga gjithsej 32 thirrje të publikuara në ueb-faqet e 16 komunave.<sup>2</sup> Ndërkaq, për monitorim vjetor janë nxjerre të dhëna nga 19 komuna.<sup>3</sup> Ndërkohë, në platformën OJQ-Financime dhe në raportin vjetor gjithëpërfshirës, financimet kane raportuar 31 komuna.<sup>4</sup>

<sup>1</sup> 16 komunat që nuk kanë planifikuar financim.

<sup>2</sup> Këto komuna përfshijnë: Dragashi, Fushë-Kosova, Gjilani, Graçanica, Kamenica, Lipjani, Malisheva, Novobërda, Obiliqi, Peja, Podujeva, Prishtina, Rahoveci, Shtimja, Suhareka dhe Vitia.

<sup>3</sup> Përfshirë 6 komuna që nuk kane pasur planifikimin por kane raportuar financim (Mamushe, Ranillug, Gjilan, Peje, Shtime, Shterpce) dhe 1 komune (Malisheven) që nuk ka pasur as planifikim as nuk ka raportuar financim.

<sup>4</sup> Prej tyre 20 nga 22 që kane planifikuar financim (perjastuar Mitrovica e Jugut dhe Parteshi) dhe 11 komuna që nuk kane planifikuar financim (Gjilan, Junik, Leposaviq, Mamushe, Peje, Ranillug, Shterpce, Shtime, Vushtrri, Zubin Potok dhe Zvecan)

Udhëzimi Administrativ për Administratë të Hapur në Komuna përcakton obligimin për publikimin e dokumenteve të krijuara gjatë proceseve të thirrjeve publike, si grante, subvencione, konkurse publike, ankande dhe dokumente të tjera përkatëse. Megjithatë, bazuar në procesin e monitorimit të financimeve publike për vitin 2023, shpesh është evidentuar mungesa e qartësisë në lidhje me detyrimin për të publikuar procesverbalet e komisioneve vlerësuese, dokumentet e ankesave dhe raportet e monitorimit. Kjo situatë tregon nevojën për përmirësime dhe zbatim më të drejtë të udhëzimit.

### **Përmirësimi i Procedurave dhe Sfidat Strategjike**

Është e rëndësishme të theksohet, se ka pasur një progres sa i përket planifikimit të financimit publik, ku në vitin 2022, kishin planifikuar vetëm 19 nga 38 komunat, ndërkaq në vitin 2023, kanë planifikuar 22 nga 38 komunat. Edhe sa i përket qasjes në planifikim, komunat kanë avancuar duke vendosur më të qarta fushat si dhe objektivat e mbështetjes financiare. Progres të konsiderueshëm ka edhe tek aspekti procedural, nisur nga përcaktimi i kriterëve të thirrjes, dokumentacionit të kërkuar dhe udhëzimeve për aplikantët. Megjithatë, në mungesë të dokumenteve strategjike, planeve të veprimit në fushat specifike si dhe të dhënave të analizuara, përshkrimi i problemit dhe vendosja e objektivave të thirrjes, ka mbetur ende e kufizuar në qasje ad-hoc.

### **Vlerësimi dhe Monitorimi**

Te vlerësimi i aplikacioneve dhe kontraktimi, sfida mbeten qasja në të dhëna si rezultat i mos publikimit të procesverbaleve të komisionit vlerësues, komisionit të ankesave, apo edhe kontratave me përfituesit. Si rezultat i kësaj, informacionet janë mbledhur nga të dhënat sekondare, nga listat preliminare, përfundimtare dhe baza e të dhënave në OJQ-financime. Ka vazhduar problemi edhe me publikimin e pikëve të përfituesve, si dhe arsyetimi për eliminimin procedural apo përmbajtësor. Sfida më e madhe e financimit publik të OJQ-ve mbeten kapacitetet si dhe procedurat për monitorim të përfituesve si dhe vlerësimi i ndikimit. Ngjashëm, kjo reflektohet edhe me mos publikimin e raporteve vjetore të financimit publik nga komunat.

### **Raportet e Auditimit dhe Përmbushja e Planeve të Veprimit**

Sa i përket çështjeve të ngritura në raportet vjetore të auditimit financiar të Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA), për vitin 2023 është evidentuar një numër më i ulët i çështjeve të theksuara lidhur me subvencionet për entitetet jopublike. Gjithashtu, është vërejtur një nivel i lartë përmbushjeje të planeve të veprimit për adresimin e gjetjeve nga viti paraprak 2022. Megjithëse është arritur progres në disa aspekte të planifikimit dhe raportimit të financimit publik, sfidat e vazhdueshme në transparencë, monitorim dhe koordinim vazhdojnë të kufizojnë efikasitetin dhe efektivitetin e këtyre proceseve. Mungesa e qasjes së lehtë në të dhënat relevante, vonesat në publikimin e dokumenteve dhe mungesa e mekanizmave të fortë për monitorim dhe vlerësim ndikojnë negativisht në cilësinë e menaxhimit të financimeve publike dhe në besimin e publikut.

Për të siguruar një përmirësim të qëndrueshëm, komunat duhet të përqendrohen në disa fusha kyçe. Së pari, është thelbësore zhvillimi i dokumenteve strategjike që përcaktojnë qartë prioritetet dhe objektivat e financimeve publike. Së dyti, publikimi i të dhënave duhet të jetë i rregullt, i qasshëm dhe i strukturuar në mënyrë që të lehtësojë monitorimin nga qytetarët dhe organizatat e interesuara.

Së treti, forcimi i kapaciteteve për monitorim dhe vlerësim të ndikimit është i domosdoshëm për të siguruar që fondet publike të përdoren në mënyrë efikase dhe të arrihet ndikimi i synuar.

Përveç kësaj, përmirësimi i bashkëpunimit midis niveleve të ndryshme të qeverisjes dhe forcimi i mekanizmave të llogaridhënies do të kontribuonin në një menaxhim më transparent dhe të përgjegjshëm të financimeve publike. Vetëm përmes një qasjeje gjithëpërfshirëse dhe të mirëkoordinuar mund të adresohen këto sfida dhe të krijohen procese më efikase dhe të qëndrueshme.

## Hyrje

Ky dokument ka për qëllim të pasqyrojë progresin në përmbushjen e indikatorëve matës nga monitorimi i zbatimit të Rregullores nr. 04/2017 mbi **Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të Organizatave Joqeveritare (OJQ)**<sup>5</sup> në nivel lokal. Raporti ndjek kronologjinë e detyrimeve të përcaktuara në këtë rregullore, duke vlerësuar zbatimin e tyre nga komunat në proceset e financimit publik për OJQ-të.

Monitorimi përfshiu katër faza kryesore të financimit publik në nivel lokal: **Planifikimi i Financimit, Aspekti Procedural, Procesi i Vlerësimit dhe Kontraktimit dhe Monitorimi dhe Raportimi.**

Në **monitorimin individual**, gjatë periudhës maj – shtator 2024, u identifikuan gjithsej 45 thirrje publike, por për shkak të problemeve teknike në ueb-faqet zyrtare të komunave, vetëm **32 prej tyre** u monitoruan me sukses, ndërsa 13 thirrje mbetën të paaksesueshme.

Në **monitorimin vjetor**, nga 38 komuna të përfshira, 22 komuna kanë dorëzuar planifikimin e financimit publik, por vetëm **19 komuna** kanë përmbushur kriteret e nevojshme për t'u përfshirë në këtë analizë.

Kërkesa për qasje në të dhëna është bërë në përputhje me **Udhëzimin Administrativ për Administratë të Hapur në Komuna**, konkretisht nenin 12, pika 1.7<sup>6</sup>, i cili përcakton publikimin e të gjitha dokumenteve të prodhuara gjatë proceseve të thirrjeve publike, përfshirë: grante, subvencione, konkurse publike, ankande dhe dokumente të tjera përkatëse.

Raporti është i strukturuar në tri pjesë kryesore:

1. **Gjetjet nga monitorimi individual** – duke përfshirë thirrjet individuale, udhëzuesit dhe dokumentet përcjellëse, si dhe zbatimin e tyre.
2. **Gjetjet nga monitorimi vjetor** – analizimi i përgatitjes administrative, monitorimit dhe raportimit të procesit të financimit publik.
3. **Thekse kryesore nga raportet vjetore të auditorit për vitin 2023.**

---

<sup>5</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=14831>

<sup>6</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=84864>

## Metodologjia

Duke u mbështetur në metodologjinë e suksesshme për monitorimin e konsultimeve publike në nivel kombëtar, KLGJ ka zhvilluar një metodologji të përshtatur për monitorimin dhe raportimin e gjithëpërfshirjes dhe transparencës në vendimmarrjen lokale.

**Instituti KLGJ** ka zbatuar një proces të strukturuar në **gjashtë faza** për monitorimin e financimit publik të **Organizatave Joqeveritare (OJQ)** në nivel lokal për vitin 2023.

**Faza e parë** përfshiu një trajnim gjysmë-ditor për organizatat dhe aktivistët, ku u prezantua metodologjia e monitorimit dhe rëndësia e tij për transparencën në qeverisjen lokale. Ky trajnim synoi forcimin e kapaciteteve të pjesëmarrësve për të ndjekur dhe vlerësuar në mënyrë efektive proceset financiare në komunat e tyre.

**Faza e dytë** përqendrohet në ofrimin e udhëzuesve praktik për monitorimin individual dhe vjetor, të cilët kanë shërbyer si mjete kyçe për standardizimin e procesit të mbledhjes dhe analizimit të të dhënave. **Monitorimi individual** u fokusua në analizën e thirrjeve të publikuara nga komunat gjatë vitit 2023. Në total, u identifikuan **32 thirrje** nga **16 komuna**, të cilat u analizuan bazuar në treguesit kryesorë. Nga ana tjetër, **monitorimi vjetor** vlerësoi performancën dhe kapacitetet zbatuese të komunave. Nga **38 komuna**, u monitoruan **19**, pasi pjesa tjetër nuk paraqitën planifikimin e nevojshëm për përfshirje në analizë.

**Faza e tretë** përfshiu një trajnim të specializuar për qeverisjen lokale, duke theksuar transparencën financiare dhe menaxhimin e fondeve publike. Qëllimi i këtij trajnimi ishte thellimi i njohurive dhe pajisja e pjesëmarrësve me aftësi për të identifikuar shkeljet ose mospërputhjet në përdorimin e fondeve.

**Faza e katërt** përfshiu një punëtori për verifikimin e të dhënave të mbledhura gjatë monitorimit, duke garantuar saktësinë dhe koherencën e raportit përfundimtar. **Faza e pestë** përqendrohet në verifikimin e të dhënave me **Zyrat për Informim në komuna**, duke rritur besueshmërinë dhe transparencën e të dhënave të mbledhura.

**Faza e fundit** rezultoi në hartimin e këtij raporti për monitorimin e financimit publik të OJQ-ve në nivel lokal për vitin 2023. Raporti përmbledh gjetjet kryesore, sfidat dhe rekomandimet, duke ofruar një pasqyrë të qartë mbi përdorimin e fondeve publike nga OJQ-të dhe duke kontribuar në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në nivel lokal.

## Procesi i Monitorimit

Kjo metodologji bazohet në ekstraktimin e treguesve të monitorimit, të cilët janë organizuar në kategori që rrjedhin nga dispozitat e parashikuara në Udhëzimin Administrativ 06/2008 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, si dhe nga sqarimet dhe interpretimet në Doracakun për Konsultim Publik në Komuna. Kategoritë përfshijnë fusha të caktuara të ndërlidhura në mënyrë logjike dhe janë të ndara në nën-kategori.

Kategoritë dhe procesi i financimit publik të OJQ-ve ndahen në dy grupe:

- Grupi i parë – monitorimi individual (Procesi i financimit të organizatave joqeveritare);
- Grupi i dytë – monitorimi vjetor (Planifikimi i procesit; Monitorimi dhe Raportimi).

Monitorimi është zbatuar në dy rrafshë: i) procesi i financimit dhe ii) procesi i planifikimit, monitorimit dhe raportimit, duke gjeneruar të dhëna specifike për komunat përkatëse. Mjetet e monitorimit, përmes treguesve, u ofrojnë palëve të interesuara (institucioneve dhe organizatave monitoruese) një qasje proaktive dhe komunikim dykahësh:

- Individët, organizatat, nëpërmjet monitorimit të vazhdueshëm dhe uniform ofrojnë pasqyrim të strukturuar të procesit;
- Komunat identifikojnë mangësitë përgjatë procesit të tërësishëm të financimit publik të OJQ-ve.

Në procesin e monitorimit janë nxjerrë informacione kryesore nga raportet e auditimit për vitin 2023 në fushën e subvencionit, me fokus në financimit publik të OJQ-ve. Përgjatë analizës së të dhënave, janë evidentuar mangësitë në secilën fushë veç e veç.

## Partnerët

Procesi i monitorimit është realizuar duke përfshirë OJQ-të dhe aktivistët në nivel lokal, të cilët janë përzgjedhur përmes një thirrjeje të hapur për pjesëmarrje. Ky proces synon të promovojë transparencën dhe llogaridhënien, duke mundësuar vlerësimin e aktiviteteve të autoriteteve lokale nga vetë komunitetet që i prekin këto veprime.

OJQ-të dhe aktivistët e përzgjedhur kanë kryer monitorime të detajuara në komunat përkatëse, duke mbledhur të dhëna, dokumentuar sfida dhe rekomanduar përmirësime për të rritur efektivitetin e shërbimeve publike dhe për të forcuar përfshirjen qytetare. Më poshtë janë të listuara organizatat pjesëmarrëse dhe komunat të cilat ato kanë monitoruar:

1. OJQ “Sundimi i Demokracisë në Kosovë” - Komunat e monitoruara: Podujevë, Glllogoc, Lipjan.
2. OJQ “New Millennium” - Komunat e monitoruara: Fushë-Kosovë dhe Obiliq.
3. OJQ “Organizata për Hulumtime Ekonomike dhe Sociale (OHES)” - Komunat e monitoruara: Suharekë, Malishevë, Mamushë.
4. OJQ “Centar za Integraciju Etničkih Zajednica (ICEC)” - Komunat e monitoruara: Prizren dhe Dragash.
5. OJQ “Aureola” - Komunat e monitoruara: Mitrovicë e Jugut dhe Skenderaj.

6. Aktivistja Arjanita Shala; Komuna e monitoruar: Vushtrri.
7. OJQ "NOPM" - Komunat e monitoruara: Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq, Zveçan.
8. OJQ "Politeia" - Komunat e monitoruara: Viti, Partesh, Kllokot, Graçanicë.
9. OJQ "Vullnetarët e Qytetit" - Komunat e monitoruara: Kamenicë, Gjilan, Ranillug, Novobërdë.
10. OJQ "Youth Association for Human Rights" - Komunat e monitoruara: Ferizaj dhe Kaçanik.
11. Aktivisti Shemsi Jashari - Komunat e monitoruara: Shtime, Hani i Elezit, Shtërpçë.
12. OJQ "Institute for Internal Audit and Controls" - Komunat e monitoruara: Istog dhe Klinë.
13. OJQ "TOKA" - Komunat e monitoruara: Pejë dhe Prishtinë.
14. OJQ "Perspektiva" - Komunat e monitoruara: Gjakovë dhe Junik.
15. Aktivistja Blerina Sallaj - Komunat e monitoruara: Rahovec dhe Deçan.

### Kufizimet e hasura gjatë Monitorimit

Përgjatë monitorimit janë hasur një seri e kufizimeve ku të grupuara dalin:

1. Kufizimet mes planifikimit, zbatimit dhe raportimit (ekziston një dallim mes planifikimit të financimit, thirrjeve të zbatuara si dhe financimeve të raportuara);
2. Kufizimet në monitorim teknik (qasja në ueb-faqe dhe mungesa e seksioneve të veçanta për subvencionet e OJQ-ve);
3. Kufizimet në qasjen në dokumente (një numër i komunave, kanë publikuar thirrjet por nuk ka qasje në dokumente);
4. Kufizimet operacionale të zbatimit të financimit të OJQ-ve (financimi nëpërmjet subvencionimit të shërbimeve si ato të varrimit, shërbimeve sociale, pagesa e anëtarësisë pa thirrje publike edhe pse përftuesit kanë statusin e OJQ-ve);
5. Kufizimet në njohuri dhe praktika (OJQ-të lokale kane kapacitete të kufizuara për të monitoruar procesin e financimit publik);
6. Kufizimet në të dhëna primare (komunat nuk publikojnë të gjitha dokumentet e prodhuara nga thirrjet publike);
7. Kufizimet në monitorim të planifikimit (është dashur të përdoren mjete rrethore/raporte për të evidentuar konsultimin e komunave me OJQ-të, përfshirë edhe monitorimin e vendosjes së objektivave të thirrjeve, në mungesë të referencës së strategjive apo planeve lokale nga dalin ato);
8. Kufizimet në monitorimin e vlerësimit dhe trajtimit të brendshëm në komuna (mospublikimi i procesverbaleve nga komisioni vlerësues/apo edhe formave të vlerësimit dhe procesverbalet e trajtimit të ankesave);
9. Qasja e kufizuar në vlerësimin (mungesa e raporteve të përmbledhura bashkë me nivelin e zbatimit, monitorimin dhe raportimin e projekteve);
10. Kufizimet në koordinimin e brendshëm komunal (në mes zyrave për informim në publikim - ofruesit të mbështetjes në qasjen pro aktive të ofrimit të informacionit - raporteve, procesverbaleve për zyrat e informimit dhe zyrtarët kryesorë financiarë për pagesat).

## VLERËSIMET INDIVIDUALE

Monitorimi i kriterëve për vlerësimin individual të komunave është realizuar në dy mënyra kryesore:

1. Duke përdorur **të dhëna primare**: Kjo metodë përfshin mbledhjen e të dhënave të drejtpërdrejta të prodhuara nga procesi i financimit publik të OJQ-ve, të tilla si (*vendimi i themelimit të komisionit vlerësues, komisionit të ankesave, thirrja publike për OJQ-të dhe ekspertët e jashtëm; procesverbali i komisionit vlerësues dhe komisionit të ankesave; kontratat me përfituesit; raporti i monitorimit; raporti final*). Kjo qasje mundëson një vlerësim të thelluar dhe të detajuar të proceseve dhe praktikave të komunave, duke siguruar një pamje më të qartë dhe të azhurnuar mbi zbatimin e kriterëve të monitoruara.
2. Duke përdorur **të dhëna sekondare**: Kjo metodë përfshin përdorimin e të dhënave të mbledhura dhe të përpunuara nga burime të ndryshme gjatë zbatimit të procesit të financimit publik, si (*përbërja e komisionit vlerësues në rezultatet preliminare; afati i ankesave në listën preliminare dhe përfundimtare; vlerësimi sipas pikëve apo organizatat e eliminuara apo diskualifikuara mes rezultateve preliminare dhe përfundimtare; informacione mbi monitorimin, kontraktimin dhe raportimin në udhëzuesit e thirrjes*); Kjo qasje, provon të mbledhë informacione nga procesi për të siguruar një vlerësim sa më objektiv të zhvillimit të procesit si dhe nxjerrë konkluzione dhe rekomandime sa më të fokusuar.

Përdorimi i të dy metodave provon të sjellë një pasqyrim sa më të gjerë të procesit të financimit publik të OJQ-ve në nivel lokal. Njëkohësisht, provohet që të evidentohen mangësitë kryesore, duke përfshirë nivelin e përgjithshëm të zbatimit si dhe problemet në secilën fazë veç e veç. Mbledhja e këtyre të dhënave, është lehtësuar nëpërmjet udhëzuesve praktik për procesin e monitorimit të hartuar nga ekipi i Institutit KLGJ.

Duke përdorur këtë metodologji monitorimi, janë analizuar **32 thirrje**, të cilat paraqiten në tabelën përmbledhëse më poshtë. Tabela shfaq listën e komunave dhe numrin e thirrjeve të monitoruara gjatë fazës së monitorimit individual për secilën komunë.

Nr.	Komuna	Nr. i Thirrjeve të Monitoruara
1.	Dragash	1
2.	Fushë-Kosovë	4
3.	Gjilan	5
4.	Graçanicë	1
5.	Kamenicë	3
6.	Lipjan	1
7.	Malishevë	1
8.	Novobërdë	1
9.	Obiliq	3
10.	Pejë	1
11.	Podujevë	1
12.	Prishtinë	1
13.	Rahovec	2

14.	Shtime	5
15.	Suharekë	1
16.	Viti	1
<b>TOTALI I THIRRJEVE TË MONITORUARA</b>		<b>32</b>

## Aspekti Procedural

### Kriteret e shpalljes publike të thirrjes<sup>7</sup>

Në përgjithësi, të dhënat e thirrjeve publike janë të shpërndara nëpër ueb-faqet e komunave dhe nuk ndjekin një strukturë të unifikuar. Në aspektin procedural, është e rëndësishme të theksohet se ekziston një kategori e subvencionimit që në planifikim trajtohet si financim i OJQ-ve, por që në praktikë përfshin karakteristika të ofrimit të shërbimeve, siç janë: shërbimet sociale, shpenzimet e varrimit, apo pagesat e anëtarësisë. Këto përfshijnë pagesa për shpenzime specifike dhe financimin e aktiviteteve për grupe apo kategori të veçanta, të cilat nuk duhet të trajtohen në të njëjtën mënyrë si financimi i përgjithshëm për OJQ-të.

Nr.	Indikatorët që vlerësojnë shpalljen publike në thirrjet e publikuara	Numri dhe Përqindja e Thirrjeve të Monitoruara			
		Numri i thirrjeve nga të dhënat primare	Numri i thirrjeve nga të dhënat sekondare	Totali i Thirrjeve (32)	
				Numri	Përqindja (%)
1.	Publikimi i thirrjes në ueb-faqen e komunës	30	0	30	94
2.	Përdorimi i formave tjera të informimit me qëllim të rritjes së konkurrueshmërisë	17	0	17	53
3.	Thirrja ka qenë hapur së paku (15) ditë pune	30	0	30	94
4.	Zgjatja e afatit të thirrjes përtej (15) ditë pune	5	4	9	28
5.	Ofrimi i mundësisë për sqarime shitesë përmes postës elektronike (e-mail)	17	0	17	53
6.	Sqarime dhe përgjigje me shkrim, dhe të njëjtat, a janë publikuar në ueb-faqe së paku (8) ditë para mbylljes së thirrjes	3	0	3	9

Tabela e mësipërme vlerëson shpalljen publike të 32 thirrjeve të publikuara, duke analizuar disa indikatorë kryesorë. Publikimi i thirrjeve në ueb-faqet zyrtare të komunave rezulton të jetë në nivel të lartë, pasi është realizuar në **30 nga 32 thirrje (94%)**. Sa i përket përdorimit të formave të tjera të informimit për të rritur konkurrueshmërinë, **17 thirrje nga 32 (53%)** kanë shfrytëzuar kanale

<sup>7</sup> Referuar Rregullores mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, Neni 12 (12.1-12.4)

shtesë si platforma OJQ-financime,<sup>8</sup> rrjetet sociale dhe takimet publike informuese. Megjithatë, është shqetësuese që asnjë komunë nuk ka publikuar thirrjet në platformën e dedikuar për financimin publik të OJQ-ve.

Respektimi i afatit minimal për hapjen e thirrjeve për së paku 15 ditë pune është përmbushur në **30 nga 32 thirrje (94%)**. Megjithatë, vetëm **9 thirrje (28%)** kanë zgjatur afatin përtej 15 ditëve, çka mund të kufizojë pjesëmarrjen e organizatave.

Është e rëndësishme të vihet në dukje dallimi midis thirrjeve për fondet që menaxhohen drejtpërdrejt nga komunat dhe atyre që bashkë-financohen. Për thirrjet e bashkë-financuara, përveç publikimit, shpesh organizohen edhe takime informuese për të ndihmuar aplikuesit. Megjithatë, një vërejtje e rëndësishme është fakti që organizatat, veçanërisht ato që përfaqësojnë grupe të cenueshme, shpesh diskualifikohen për mungesë dokumentacioni. Kjo ndodh kryesisht për shkak të informimit të pamjaftueshëm ose mungesës së asistencës teknike për plotësimin e dokumenteve të nevojshme.

Sa i përket aspektit të komunikimit, mundësia për të ofruar sqarime përmes postës elektronike është garantuar vetëm në **17 thirrje nga 32 (53%)**. Një tjetër mangësi e theksuar është publikimi i sqarimeve dhe përgjigjeve me shkrim së paku 8 ditë para mbylljes së thirrjes, që është realizuar vetëm në **3 nga 32 thirrje (9%)**.

Këto të dhëna tregojnë për progres në disa aspekte të shpalljes publike, por theksojnë edhe sfidat në lidhje me informimin gjithëpërfshirës, transparencën dhe mbështetjen teknike për aplikantët, veçanërisht për organizatat më të cenueshme.

### **Kriteret e thirrjes publike dhe dokumentacioni i kërkuar<sup>9</sup>**

Kjo fushë përfshin indikatorët që vlerësojnë strukturën e thirrjes, përfshirë dokumentet përcjellëse si udhëzimet, formularin për përgatitjen e projektit/programit, formularin e buxhetit, listën e dokumenteve të kërkuara, si dhe datat e hapjes dhe mbylljes së thirrjes, si dhe mënyrën e dorëzimit të aplikacioneve.

Nr.	Indikatorët që vlerësojnë publikimin e thirrjes në ueb-faqen e komunës për thirrjet e publikuara	Numri dhe Përqindja e Thirrjeve të Monitoruara			
		Numri i thirrjeve nga të dhënat primare	Numri i thirrjeve nga të dhënat sekondare	Totali i Thirrjeve (32)	
				Numri	Përqindja (%)
7.	Udhëzimet	27	1	28	88
8.	Formulari i projektit	27	2	29	91
9.	Formulari i buxhetit	28	1	29	91

<sup>8</sup> <https://ojqfinancime.rks-gov.net/>

<sup>9</sup> Neni 13 (1.1 – 1.5)

10.	Lista e dokumenteve	31	0	<b>31</b>	<b>97</b>
11.	Afatet (hapja/mbyllja)	29	0	<b>29</b>	<b>91</b>
12.	Mënyra e aplikimit	3	2	<b>5</b>	<b>16</b>

Tabela vlerëson indikatorët për publikimin e thirrjeve në ueb-faqen e komunës, duke analizuar numrin total të thirrjeve të monitoruara. Sa i përket udhëzimeve, nga gjithsej 32 thirrje, **28** kanë publikuar udhëzimet për aplikuesit, që përbën **88%** të thirrjeve. Formulari i projektit është publikuar në **29 thirrje** (27 nga të dhënat primare dhe 2 nga të dhënat sekondare), duke arritur një përqindje të lartë prej **91%**. Po ashtu, formulari i buxhetit është përfshirë në **29 thirrje** (28 nga të dhënat primare dhe 1 nga të dhënat sekondare), që gjithashtu përfaqëson **91%** të totalit.

Lista e dokumenteve shfaqet si indikator me nivelin më të lartë të përmbushjes, duke u përfshirë në **31 thirrje** nga 32 (97%), një rezultat që reflekton përkujdesje të mirë për dokumentacionin shoqëruar të thirrjeve. Për afatet e hapjes dhe mbylljes, **29 thirrje** i kanë respektuar këto, duke përbërë sërish **91%** të totalit. Megjithatë, mënyra e aplikimit mbetet treguesi më i ulët, pasi është publikuar vetëm në **5 thirrje** nga 32, përkatësisht **16%**.

#### **Përmbajtja e udhëzimeve për aplikantët<sup>10</sup>**

Nr.	Indikatorët që vlerësojnë përmbajtjen e udhëzimeve për aplikantët në thirrjet e publikuara	Numri dhe Përqindja e Thirrjeve të Monitoruara			
		Numri i thirrjeve nga të dhënat primare	Numri i thirrjeve nga të dhënat sekondare	Totali i Thirrjeve (32)	
				Numri	Përqindja (%)
13.	Përshkrimi i problemit	21	3	<b>24</b>	<b>75</b>
14.	Objektivat e thirrjes	26	4	<b>30</b>	<b>94</b>
15.	Përshkrimi i fushave	26	3	<b>29</b>	<b>91</b>
16.	Numri i përafërt i kontratave	6	3	<b>9</b>	<b>28</b>
17.	Shuma e mjeteve financiare	16	3	<b>19</b>	<b>59</b>
18.	Shumat më të ulëta/ larta - numri i projekteve	13	8	<b>21</b>	<b>66</b>
19.	Kohëzgjatja	18	3	<b>21</b>	<b>66</b>
20.	Organizatat që kualifikohen	26	5	<b>31</b>	<b>97</b>
21.	Parimet prioritare	18	3	<b>21</b>	<b>66</b>

<sup>10</sup> Neni 14 (2.1 - 2.19, 3, 4)

22.	Aktivitetet e kualifikuara	20	1	<b>21</b>	<b>66</b>
23.	Shpenzimet e pranueshme/të pa pranueshme	10	0	<b>10</b>	<b>31</b>
24.	Dokumentacioni i detyrueshëm dhe jo të detyrueshme për aplikim	26	0	<b>26</b>	<b>81</b>
25.	Data e hapjes/mbylljes	26	0	<b>26</b>	<b>81</b>
26.	Paraqitja e adresës	26	2	<b>28</b>	<b>88</b>
27.	Kushtet dhe mënyra e parashtrimit të pyetjeve	21	2	<b>23</b>	<b>72</b>
28.	Mënyra e publikimit të përgjigjeve	6	0	<b>6</b>	<b>19</b>
29.	Kushtet dhe mënyra e paraqitjes së ankesave	12	5	<b>17</b>	<b>53</b>
30.	Informacioni mbi kontraktimin	8	4	<b>12</b>	<b>38</b>
31.	Procedura për monitorim si dhe metoda dhe përmbajtja e raportimit	4	2	<b>6</b>	<b>19</b>
32.	Paraqitja e kalendarit tentativë për zbatimin të procedurës së thirrjes	13	2	<b>15</b>	<b>47</b>
33.	Korrigjimet e thirrjeve	2	1	<b>3</b>	<b>9</b>
34.	Mundësia për ndryshimeve nga aplikantët	5	4	<b>9</b>	<b>28</b>

Pas vlerësimit të kriterëve të thirrjeve dhe dokumentacionit të kërkuar, janë analizuar 22 indikatorë për përfshirjen e udhëzimeve për aplikantët në thirrjet e publikuara. Tabela vlerëson përmbajtjen e udhëzimeve për aplikantët në **32 thirrjet e monitoruara**, duke analizuar elementët kryesorë të përfshirë në to. Përshkrimi i problemit është i pranishëm në **24 thirrje** (75%), ndërsa objektivat e thirrjes janë identifikuar në **30 thirrje** (94%), duke treguar pëmbushje të lartë të këtij indikator. Sa i përket përshkrimit të fushave, ky element është përfshirë në **29 thirrje** (91%).

Numri i përafërt i kontratave është treguar në vetëm **9 thirrje** (28%), ndërsa shuma e mjeteve financiare është e qartë në **19 thirrje** (59%). Shumat më të ulëta dhe më të larta të projekteve janë përfshirë në **21 thirrje** (66%), po ashtu si kohëzgjatja e projektit, e cila është prezentë në **21 thirrje** (66%). Organizatat që kualifikohen për aplikim janë specifikuar në **31 thirrje** (97%), duke reflektuar transparencë të lartë në këtë aspekt.

Për parimet prioritare dhe aktivitetet e kualifikuara, të dy indikatorët janë të pranishëm në nga **21 thirrje** (66%). Ndërkohë, shpenzimet e pranueshme dhe të papranueshme janë përcaktuar vetëm në **10 thirrje** (31%). Dokumentacioni i detyrueshëm dhe jo i detyrueshëm për aplikim dhe data e hapjes/mbylljes janë përfshirë në **26 thirrje** (81%).

Sa i përket paraqitjes së adresës, ky element është evidentuar në **28 thirrje** (88%), ndërsa kushtet dhe mënyra e parashtrimit të pyetjeve janë specifikuar në **23 thirrje** (72%). Mënyra e publikimit të përgjigjeve rezulton të jetë ndër indikatorët me performancën më të ulët, e përfshirë vetëm në **6 thirrje** (19%).

Kushtet dhe mënyra e paraqitjes së ankesave janë të qarta në **17 thirrje** (53%), ndërsa informacioni mbi kontraktimin është përfshirë në **12 thirrje** (38%). Procedura për monitorim dhe metoda e raportimit janë specifikuar në **6 thirrje** (19%), ndërsa kalendarët tentative për zbatimin e thirrjeve janë të pranishëm në **15 thirrje** (47%).

Për korrigjimet e thirrjeve, ky indikator është përmbushur në vetëm **3 thirrje** (9%), ndërsa mundësia për ndryshime nga aplikantët është e përcaktuar në **9 thirrje** (28%).

### Mënyra e Aplikimit<sup>11</sup>

Në këtë kategori, fokusi ka qenë në vlerësimin e mundësive që ofrojnë thirrjet për aplikimin përmes postës elektronike (e-mail). Sipas manualit për implementimin e rregullores mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit të OJQ-ve, përdorimi i regjistrave digjitalë është i kufizuar vetëm për aplikimet fizike dhe regjistrimin e protokollit fizik në zyrat pritëse. Kjo është gjithashtu në përputhje me rregulloren për financimin e OJQ-ve, e cila e kufizon aplikimin vetëm në formën e zarfeve dhe një kopjeje elektronike në CD<sup>12</sup>.

Nr.	Indikatorët që vlerësojnë mënyrën e aplikimit në thirrjet e publikuara	Numri dhe Përqindja e Thirrjeve të Monitoruara			
		Numri i thirrjeve nga të dhënat primare	Numri i thirrjeve nga të dhënat sekondare	Totali i Thirrjeve (32)	
				Numri	Përqindja (%)
35.	Aplikimi përmes E-mailit	21	0	21	66
36.	Formati i dokumentacionit	26	0	26	81
37.	Aplikimi në platforma elektronike	4	0	4	13
38.	Adresa dhe afati i aplikimit	30	1	31	97

Tabela vlerëson indikatorët që lidhen me mënyrën e aplikimit në thirrjet e publikuara, duke analizuar numrin total të thirrjeve të monitoruara. Aplikimi përmes e-mailit është përcaktuar në **21 thirrje nga 32**, që përbën **66%** të totalit, duke treguar përdorimin e këtij kanali si një opsion të zakonshëm për aplikim. Sa i përket formatit të dokumentacionit, ky është specifikuar në **26 thirrje** ose **81%**, duke reflektuar një nivel të mirë të qartësisë mbi mënyrën e përgatitjes së dokumenteve.

Megjithatë, aplikimi në platforma elektronike mbetet shumë i kufizuar, pasi është ofruar vetëm në **4 thirrje**, që përfaqëson një përqindje të ulët prej **13%**. Nga ana tjetër, adresa dhe afati i aplikimit

<sup>11</sup> Neni 15 (1 – 4)

<sup>12</sup> Neni 15 (1)

janë përcaktuar në **31 thirrje** (30 nga të dhënat primare dhe 1 nga të dhënat sekondare), duke arritur një përqindje të lartë prej **97%**.

Në përgjithësi, të dhënat tregojnë një përmbushje të lartë të indikatorëve për adresën dhe afatin e aplikimit, si dhe për formatin e dokumentacionit, ndërsa përdorimi i platformave elektronike për aplikim mbetet një sfidë e rëndësishme që kërkon përmirësim për të rritur efikasitetin dhe aksesin në thirrjet publike.

## Procesi i Vlerësimit dhe Kontraktimi

### Vlerësimi i aplikacioneve nga aspekti procedural<sup>13</sup>

Nr.	Indikatorët që vlerësojnë aplikacionet nga aspekti procedural në thirrjet e publikuara	Numri dhe Përqindja e Thirrjeve të Monitoruara			
		Numri i thirrjeve nga të dhënat primare	Numri i thirrjeve nga të dhënat sekondare	Totali i Thirrjeve (32)	
				Numri	Përqindja (%)
39.	Pasqyrimi i komunave që janë gjetur të dhëna mbi procesin e vlerësimit	4	1	5	16
40.	Vlerësimi i aplikacioneve nga aspekti procedural	4	3	7	22

Në këtë fushë është analizuar procesi i punës së komisionit vlerësues. Monitoruesit janë udhëzuar të mbledhin të dhëna në dy mënyra: së pari, duke kërkuar informacione nëse procesverbali i komisionit vlerësues është publikuar në faqen zyrtare të komunës përkatëse; dhe së dyti, duke verifikuar këto informacione përmes Zyrës për Informim.

Tabela vlerëson indikatorët që lidhen me aplikacionet nga aspekti procedural në thirrjet e publikuara, duke analizuar numrin total të thirrjeve të monitoruara. Pasqyrimi i komunave që kanë siguruar të dhëna mbi procesin e vlerësimit është evidentuar vetëm në **5 thirrje nga 32**, që përbën **16%** të totalit. Kjo tregon një mungesë të theksuar të transparencës dhe dokumentimit të procesit të vlerësimit në shumicën e komunave.

Nga ana tjetër, vlerësimi i aplikacioneve nga aspekti procedural është përfshirë në **7 thirrje nga 32**, përkatësisht **22%** të totalit. Edhe pse ky tregues përfaqëson një përmirësim të lehtë krahasuar me pasqyrimin e të dhënave, përqindja mbetet ende shumë e ulët.

Në përgjithësi, të dhënat e tabelës tregojnë një nivel të ulët të dokumentimit dhe transparencës për aspektin procedural të vlerësimit të aplikacioneve. Kjo tregon nevojën për ndërhyrje të mëtejshme për të siguruar që procesi i vlerësimit të jetë më i qartë, më i dokumentuar dhe i aksesueshëm për palët e interesuara.

<sup>13</sup> Neni 17 (1 -2)

## Vlerësimi përmbajtjesor<sup>14</sup>

Nr.	Indikatorët që vlerësojnë publikimin e thirrjes në ueb-faqen e komunës në thirrjet e publikuara	Numri dhe Përqindja e Thirrjeve të Monitoruara			
		Numri i thirrjeve nga të dhënat primare	Numri i thirrjeve nga të dhënat sekondare	Totali i Thirrjeve (32)	
				Numri	Përqindja (%)
41.	Poentimi deri në 100 pikë	5	1	6	19
42.	Diskualifikimi i aplikantëve nën 50 pikë	4	1	5	16
43.	Numri i të listuarve sipas pikëve	4	0	4	13

Kjo fushë është vlerësuar në dy mënyra: së pari, monitoruesit janë udhëzuar të kërkojnë procesverbalin e Komisionit Vlerësues; së dyti, në mungesë të tij, ata kanë krahasuar disa nga fushat mes rezultateve preliminare dhe përfundimtare të thirrjeve.

Tabela vlerëson indikatorët që lidhen me publikimin e rezultateve të thirrjeve në ueb-faqet e komunave, duke analizuar numrin total të thirrjeve të monitoruara. Poentimi deri në 100 pikë është publikuar vetëm në **6 thirrje nga 32**, që përbën **19%** të totalit, duke treguar një nivel të ulët transparence në shpalljen e sistemit të vlerësimit.

Për indikatorin diskualifikimi i aplikantëve nën 50 pikë, të dhëna janë gjetur në vetëm **5 thirrje nga 32**, që përfaqëson **16%** të totalit. Kjo tregon një mungesë të konsiderueshme në informimin e qartë dhe të strukturuar për aplikantët e diskualifikuar.

Sa i përket numrit të të listuarve sipas pikëve, ky tregues është publikuar vetëm në **4 thirrje nga 32**, përkatësisht **13%**. Ky rezultat tregon një nivel të ulët publikimi të rezultateve të detajuara për aplikantët, duke kufizuar transparencën dhe aksesin në informacion për palët e interesuara.

## Kërkesat për dëshmi të Komisionit Vlerësues për aplikantët e përzgjedhur<sup>15</sup>

Nr.	Indikatorët që vlerësojnë kërkesat për dëshmi të Komisionit Vlerësues për aplikantët e përzgjedhur në thirrjet e publikuara	Numri dhe Përqindja e Thirrjeve të Monitoruara			
		Numri i thirrjeve nga të dhënat primare	Numri i thirrjeve nga të dhënat sekondare	Totali i Thirrjeve (32)	
				Numri	Përqindja (%)
44.	Dëshmitë e obligimeve tatimore	6	8	14	44
45.	Statusi i përfitimit publik	5	7	12	38
46.	Dëshmi se nuk janë në procedurë të shuarjes	4	7	11	34

<sup>14</sup> Neni 18 (3, 4, 6)

<sup>15</sup> Neni 20 (3.1 – 3.4, 4, 5)

47.	Dëshmi se nuk janë në procedurë të çregjistrimit	2	7	<b>9</b>	<b>28</b>
48.	Deklarata vjetore tatimore	3	8	<b>11</b>	<b>34</b>
49.	Shqyrtimi i aplikacioneve në listën e pritjes	3	0	<b>3</b>	<b>9</b>
50.	Përmbyllja e afatit të ankesave për shpalljen e rezultateve	6	1	<b>7</b>	<b>22</b>

Informacionet për këtë fushë të vlerësimit janë siguruar përmes procesverbaleve të komisioneve vlerësuese të publikuara në faqet zyrtare të komunave, si dhe përmes konfirmimeve nga Zyrat për Informim. Në mungesë të procesverbaleve, janë përdorur të dhënat e publikuara në thirrje dhe udhëzimet për aplikim.

Tabela vlerëson indikatorët që lidhen me kërkesat për dëshmi të Komisionit Vlerësues për aplikantët e përzgjedhur në thirrjet e publikuara, duke analizuar numrin total të thirrjeve të monitoruara. Dëshmitë e obligimeve tatimore janë kërkuar në **14 thirrje nga 32**, që përbën **44%** të totalit, duke treguar një nivel të moderuar të përfshirjes së këtij dokumenti si kriter i rëndësishëm. Statusi i përfitimit publik është kërkuar në **12 thirrje** ose **38%** të totalit, duke reflektuar një transparencë të kufizuar në këtë aspekt.

Sa i përket dëshmimeve që aplikantët nuk janë në procedurë të shuarjes, ky indikator është evidentuar vetëm në **11 thirrje nga 32**, përkatësisht **34%** të totalit. Dëshmia se aplikantët nuk janë në procedurë të çregjistrimit është përfshirë në **9 thirrje** (28%), duke treguar një përfshirje të ulët për këtë element verifikimi.

Deklarata vjetore tatimore është kërkuar në **11 thirrje nga 32** (34%), ndërsa shqyrtimi i aplikacioneve në listën e pritjes është përmendur vetëm në **3 thirrje** (9%), që është një nga treguesit me përfshirjen më të ulët. Sa i përket përmblyes së afatit të ankesave për shpalljen e rezultateve, ky kriter është përmbushur në **7 thirrje** (22%).

Në përgjithësi, tabela tregon se kërkesat për dokumente dhe dëshmi nga Komisionet Vlerësuese janë zbatuar në një pjesë të kufizuar të thirrjeve, me përqindje që variojnë nga **9%** deri në **44%**. Këto të dhëna nënvizojnë nevojën për një standardizim më të mirë dhe përmirësim të transparencës në procesin e verifikimit të aplikantëve të përzgjedhur në thirrjet publike.

### Afatet dhe procedurat e shqyrtimit të ankesave<sup>16</sup>

Për këtë fushë, monitoruesit janë udhëzuar të nxjerrin të dhëna nga procesverbalet e Komisionit të Ankesave të publikuara në faqet zyrtare të komunave dhe t'i konfirmojnë ato me Zyrat Komunale për Informim.

<sup>16</sup> Neni 21 (1.1 -1.2, 3, 6, 7)

Nr.	Indikatorët që vlerësojnë afatet dhe procedurat e paraqitjes dhe shqyrtimit të ankesave në thirrjet e publikuara	Numri dhe Përqindja e Thirrjeve të Monitoruara			
		Numri i thirrjeve nga të dhënat primare	Numri i thirrjeve nga të dhënat sekondare	Totali i Thirrjeve (32)	
				Numri	Përqindja (%)
51.	Ankesat për aspektin procedural	1	0	1	3
52.	Ankesat për financim	2	0	2	6
53.	Vendimi brenda 5 ditëve i komisionit	2	0	2	6
54.	Ndarja e vendimit me palët	2	0	2	6
55.	Publikimi i procesverbalit nga komisioni i ankesave	2	1	3	9

Tabela vlerëson indikatorët që lidhen me afatet dhe procedurat e paraqitjes dhe shqyrtimit të ankesave në thirrjet e publikuara, duke analizuar numrin total të thirrjeve të monitoruara. Ankesat për aspektin procedural janë evidentuar në vetëm **1 thirrje nga 32**, që përbën **3%** të totalit, duke treguar një përfshirje minimale të këtij elementi në proceset e vlerësimit të ankesave.

Ankesat për financim janë raportuar në **2 thirrje (6%)**, duke treguar se vetëm një numër i kufizuar thirrjesh kanë përfshirë këtë mundësi për shqyrtimin e vendimeve financiare. Po ashtu, vendimi brenda 5 ditëve i komisionit të ankesave është përmbushur në **2 thirrje (6%)**, duke reflektuar një transparencë dhe efikasitet të kufizuar në menaxhimin e afateve për shqyrtimin e ankesave.

Sa i përket ndarjes së vendimit me palët, ky indikator është përmbushur në **2 thirrje (6%)**, që tregon një përqindje të ulët të shpërndarjes zyrtare të vendimeve të marra nga komisionet e ankesave. Nga ana tjetër, publikimi i procesverbalit nga komisioni i ankesave është evidentuar në **3 thirrje nga 32**, që përbën **9%** të totalit, duke reflektuar një përpjekje të kufizuar për të dokumentuar dhe bërë transparente procesin e shqyrtimit të ankesave.

### Kontrata me përfituesin<sup>17</sup>

Fusha e fundit përfshin indikatorë që lidhen me procedurat e kontraktimit. Monitoruesit janë udhëzuar të kërkojnë informacion në faqet e internetit të komunave dhe disa të dhëna janë verifikuar përmes udhëzuesit për aplikim. Më pas, monitoruesit janë kyçur në platformën OJQ-financime dhe kanë analizuar tabelën e të dhënave të hollësishme sipas formularit F20 në bazën e të dhënave.<sup>18</sup>

<sup>17</sup> Neni 22 (1, 2.1 – 2.7)

<sup>18</sup> [Baza e të dhënave e financimit të OJQ-ve – Mbeshtetja Financiare Publike për OJQ \(rks-gov.net\)](#)

Nr.	Indikatorët që vlerësojnë kontrata me përfituesin në thirrjet e publikuara	Numri dhe Përqindja e Thirrjeve të Monitoruara			
		Numri i thirrjeve nga të dhënat primare	Numri i thirrjeve nga të dhënat sekondare	Totali i Thirrjeve (32)	
				Numri	Përqindja (%)
56.	Lidhja e kontratës brenda 90 ditësh	2	8	10	31
57.	Shuma e financimit/periudha e zbatimit/monitorimi i zbatimit/raportimi	3	5	8	25
58.	Dispozita për qëllimin e mbështetjes financiare dhe ndalimin e përdorimit për qëllime tjera	1	4	5	16
59.	Dispozita e shpenzimit të mjeteve financiare përmes transaksioneve bankare sipas ligjit në fuqi	0	3	3	9
60.	Dispozita për mënyrën dhe afatet e pagesave dhe shumën e paradhënies	0	3	3	9
61.	Dispozita mbi shmangien e konfliktit të interesit	0	3	3	9
62.	Dispozita mbi shkëputjen e kontratës	0	3	3	9
63.	Dispozita mbi kthimin e mjeteve në rast të shkëputjes të kontratës	0	3	3	9

Tabela vlerëson indikatorët që lidhen me kontratat me përfituesit në thirrjet e publikuara, duke analizuar numrin total të thirrjeve të monitoruara. Lidhja e kontratës brenda 90 ditësh është evidentuar në **10 thirrje nga 32** (31%). Shuma e financimit, periudha e zbatimit, monitorimi i zbatimit dhe raportimi janë të përfshira në **8 thirrje** (25%).

Sa i përket dispozitës për qëllimin e mbështetjes financiare dhe ndalimin e përdorimit për qëllime të tjera, ky indikator është përfshirë në vetëm **5 thirrje nga 32** (16%). Dispozita për shpenzimin e mjeteve financiare përmes transaksioneve bankare, sipas legjislacionit në fuqi, është përmbushur në **3 thirrje** (9%). Po ashtu, dispozita për mënyrën dhe afatet e pagesave dhe shumën e paradhënies është evidentuar vetëm në **3 thirrje** (9%).

Indikatorët për shmangien e konfliktit të interesit, shkëputjen e kontratës dhe kthimin e mjeteve në rast të shkëputjes së kontratës kanë një nivel të ulët përfshirjeje, duke u evidentuar secili vetëm në **3 thirrje nga 32** (9%).

**Monitorimi dhe raportimi i projekteve/programeve<sup>19</sup>**

Të dhënat për këtë fushë janë siguruar përmes raporteve përmbledhëse të ofruesit të mbështetjes financiare, të publikuara në faqet e internetit të komunave, si dhe përmes krahasimit të tabelave dhe formularit F20 në bazën e të dhënave, dhe raportit gjithëpërfshirës vjetor.<sup>20</sup> Kjo fushë përfshin gjithashtu të dhënat nga monitorimi vjetor, duke përfshirë themelimin e ekipit monitorues, përgatitjen e planifikimit dhe raportimit, dhe përdorimin e platformës OJQ-financime.

Nr.	Indikatorët që vlerësojnë monitorimin dhe raportimin e projekteve/programeve	Numri dhe Përqindja e Thirrjeve të Monitoruara			
		Numri i thirrjeve nga të dhënat primare	Numri i thirrjeve nga të dhënat sekondare	Totali i Thirrjeve (32)	
				Numri	Përqindja (%)
64.	Caktimi i zyrtarit për monitorim	2	2	4	13
65.	Raportimi tek zyrtari/ekipi monitorues	3	1	4	13
66.	Evidentimi i shkeljeve	2	1	3	9
67.	Raportimi i zyrtarit/ekipit monitorues tek ZKA	1	1	2	6
68.	Shkëputje e kontratave për shkelje të rënda	1	0	1	3
69.	Vendim për anulimin e kontratës	1	0	1	3
70.	Masa për iniciimin e procedurave gjyqësore	2	1	3	9

Tabela vlerëson indikatorët që lidhen me monitorimin dhe raportimin e projekteve/programeve në thirrjet e publikuara, duke analizuar numrin total të thirrjeve të monitoruara. Caktimi i zyrtarit për monitorim është evidentuar në **4 thirrje nga 32** (13%), me të dhëna të barabarta nga burimet primare dhe sekondare. Raportimi tek zyrtari ose ekipi monitorues është identifikuar po ashtu në **4 thirrje** (13%), duke treguar një nivel të ngjashëm përfshirjeje.

Sa i përket evidentimit të shkeljeve, ky indikator është përmbushur në **3 thirrje nga 32** (9%). Raportimi i zyrtarit ose ekipit monitorues tek Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) është përfshirë në vetëm **2 thirrje** (6%), duke reflektuar një përqindje shumë të ulët. Shkëputja e kontratave për shkelje të rënda dhe vendimi për anulimin e kontratës janë identifikuar secili vetëm në **1 thirrje nga 32** (3%). Për masat për iniciimin e procedurave gjyqësore, ky indikator është përfshirë në **3 thirrje** (9%), me të dhëna të kombinuara nga burimet primare dhe sekondare.

<sup>19</sup> Neni 23 (1 -4)

<sup>20</sup> <http://ojqfinancime.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/07/RaportiVjetor2022.pdf>.

## MONITORIMET VJETORE

Monitorimi vjetor përfshin një hartëzim të plotë të procesit të financimit publik, duke mbuluar të gjitha fazat kryesore: planifikimin, zbatimin, monitorimin dhe raportimin. Ky proces ofron një pasqyrë të detajuar mbi hallkat e dobëta dhe sfidat e identifikuara, duke u fokusuar në tre elementë kryesorë: nivelin e përgatitjes administrative për procesin e financimit, zbatimin e rregullores për financimin publik dhe nivelin e planifikimit, monitorimit dhe raportimit të financimit në baza vjetore.

Përveç vlerësimit të performancës vjetore, monitorimi analizon edhe kapacitetet zbatuese të komunave për të siguruar një menaxhim më efektiv të procesit. Nga 38 komuna të përfshira në këtë monitorim, vetëm 19 janë përfshirë në analizë, pasi pjesa tjetër nuk kanë paraqitur planifikimin e nevojshëm për vlerësim.

### Planifikimi i Mbështetjes Financiare

#### Planifikimi i mbështetjes financiare<sup>21</sup>

Në këtë fushë, monitoruesit janë udhëzuar të ndjekin planin vjetor të financimit të komunave përmes ueb-faqeve. Kur ky plan nuk është publikuar online, është marrë në konsideratë vlerësimi i programimit në planin vjetor të mbështetjes financiare në platformën OJQ-financime.

Nr.	Indikatorët që vlerësojnë informacionet e raportuara për projektet/programet e mbështetura me fonde publike	Nr. i komunave që i kanë zbatuar indikatorët	Përqindja (%) e komunave që i kanë zbatuar indikatorët
1.	A ka krijuar kod të veçantë ekonomik Ministria e Financave për organizatën buxhetore?	16	84
2.	A është planifikuar mbështetja financiare në kuadër të buxhetit Vjetor, në Linjë me objektivat strategjike dhe në konsultim me shoqërinë civile?	5	26
3.	A i ka plotësuar kushtet organizata buxhetore të parapara në 1.1.1 dhe 1.1.2, për të ofruar mbështetje financiare për OJQ-të?	11	58
4.	A është përgatitur plani vjetor i mbështetjes financiare, më së largu tridhjetë (30) ditë pas miratimit të buxhetit vjetor?	7	37

Monitoruesit kanë siguruar të dhëna për të gjitha komunat që kanë paraqitur planin vjetor, duke krijuar një kod të veçantë ekonomik për organizatën buxhetore nga Ministria e Financave. Nga **19 komunat e monitoruara, 16 komuna (84%)** kanë krijuar një kod të veçantë ekonomik<sup>22</sup> nga

<sup>21</sup> Neni 5 (3, 1, 4)

<sup>22</sup> Ferizaj, Graçanicë, Fushë Kosovë, Lipjan, Rahovec, Obiliq, Drenas, Hani i Elezit, Klinë, Partesh, Suharekë, Novobërdë; dhe komunat që nuk kanë paraqitur plan por kanë pasur kod ekonomik Peje, Gjilan, Mamushe, Shtime

Ministria e Financave për organizatën buxhetore. Vetëm **5 komuna (26%)** kanë planifikuar mbështetjen financiare brenda buxhetit vjetor, në përputhje me objektivat strategjike dhe në konsultim me shoqërinë civile. **11 komuna (58%)** kanë përmbushur kushtet e parapara në nenet përkatëse për të ofruar mbështetje financiare për OJQ-të. Ndërkohë, **7 komuna (37%)** kanë përgatitur planin vjetor të mbështetjes financiare brenda afatit prej 30 ditësh pas miratimit të buxhetit vjetor.

### Plani vjetor i mbështetjes financiare<sup>23</sup>

Në këtë fushë, monitoruesit janë udhëzuar të vlerësojnë nëse plani vjetor i mbështetjes financiare është përgatitur brenda afateve dhe në përputhje me kërkesat e rregullores për financimin publik të OJQ-ve. Të dhënat janë mbledhur nga planifikimi vjetor në komunat përkatëse, duke kontrolluar në ueb-faqe të komunave dhe, nëse këto informata nuk janë gjetur, nga platforma OJQ-financime.

Nr.	Indikatorët që vlerësojnë informacionet e raportuara për projektet/programet e mbështetura me fonde publike	Nr. i komunave që i kanë zbatuar indikatorët	Përqindja (%) e komunave që i kanë zbatuar indikatorët
5.	Informata për organizatën buxhetore	9	47
6.	Shumën e mbështetjes financiare për vitin fiskal;	9	47
7.	Fushën/fushat në të cilat do të ofrohet mbështetja financiare për OJQ	9	47
8.	Objektivat e mbështetjes financiare	7	37
9.	Numrin e përafërt të organizatave që do të përfitojnë	8	42
10.	Kohën e hapjes së thirrjes për aplikime;	8	42
11.	Kohën e përafërt të fillimit të zbatimit të projekteve/ programeve përfituese	8	42
12.	A e ka publikuar institucioni përkatës pjesën e vetë të planit vjetor të mbështetjes financiare për OJQ-të, më së largu dyzetepesë (45) ditë pas miratimit të buxhetit ?	5	26
13.	A e ka përgatitur Zyra e Kryeministrit planin përmbledhës vjetor të mbështetjes financiare për OJQ-të, më së largu pas 45 ditëve pas miratimit të buxhetit të Republikës së Kosovës?	10	53
14.	A e ka publikuar ZQM-ja planin përmbledhës vjetor të mbështetjes financiare për OJQ-të në faqen e saj elektronike?	13	68%

<sup>23</sup> Neni 6 (1,2, 1.1 – 1.7, 3, 2)

Të dhënat e siguruar për këtë fushë tregojnë një përmbushje të ndryshme të detyrimeve në nivel komunal. Tabela pasqyron numrin e komunave që kanë zbatuar indikatorët për informacionet e raportuara mbi projektet/programet e mbështetura me fonde publike. **9 komuna (47%)** kanë përfshirë informata për organizatën buxhetore, shumën e mbështetjes financiare për vitin fiskal, si dhe fushat ku ofrohet mbështetja financiare për OJQ-të. **7 komuna (37%)** kanë specifikuar objektivat e mbështetjes financiare, ndërsa **8 komuna (42%)** kanë raportuar numrin e përafërt të organizatave që do të përfitojnë, kohën e hapjes së thirrjes për aplikime, dhe kohën e përafërt të fillimit të zbatimit të projekteve ose programeve përfituese.

Vetëm **5 komuna (26%)** kanë publikuar pjesën e tyre të planit vjetor të mbështetjes financiare për OJQ-të brenda 45 ditëve pas miratimit të buxhetit. Ndërkohë, **10 komuna (53%)** kanë raportuar përgatitjen e planit përmbledhës vjetor të mbështetjes financiare nga Zyra e Kryeministrit (ZQM) brenda afatit prej 45 ditësh pas miratimit të buxhetit të Republikës së Kosovës. Për më tepër, **13 komuna (68%)** kanë publikuar planin përmbledhës vjetor në faqen elektronike të ZQM-së.

### Mekanizmat e Zbatimit të Procesit

#### Komisioni Vlerësues<sup>24</sup>

Në këtë fushë, monitoruesit janë udhëzuar të gjejnë vendimin për komisionin vlerësues. Në rast se këto të dhëna nuk janë siguruar, është parashikuar që një pjesë e informacioneve të nxirren nga thirrja për aplikim, lista preliminare dhe ajo përfundimtare. Informatat e mbledhura përfshijnë përbërjen, kohëzgjatjen dhe mandatin e komisionit vlerësues, sipas vendimit nga Zyrtari Kryesor Administrativ.

Nr.	Indikatorët që vlerësojnë informacionet e raportuara për projektet/programet e mbështetura me fonde publike	Nr. i komunave që i kanë zbatuar indikatorët	Përqindja (%) e komunave që i kanë zbatuar indikatorët
15.	A është përcaktuar përbërja, kohëzgjatja dhe mandati i komisionit, me vendim të Zyrtarit Kryesor Administrativ?	11	58
16.	A është përfshirë një (1) përfaqësues nga njësia përkatëse, në kuadër të së cilës është planifikuar mbështetja financiare?	11	58
17.	A janë përfshirë dy (2) përfaqësues nga grupi i ekspertëve të jashtëm?	11	58
18.	A është njëri nga ta përfaqësues i OJQ-ve?	11	58
19.	A janë zgjedhur përmes një thirrje publike të cilën do ta bëjë ofruesi i mbështetjes financiare?	9	47
20.	A janë përfshirë dy (2) përfaqësues nga institucioni që ofron mbështetjen financiare,	7	37

<sup>24</sup> Neni 8 (2, 3, 3.1 -3.3, 5, 6, 7)

	njëri nga të cilët duhet të jetë nga njësia përkatëse për buxhet/financa?		
21.	A është themeluar Komisioni Vlerësues gjatë kohës sa thirrja publike është e hapur?	9	47
22.	A janë bërë publik emrat e anëtarëve të Komisionit Vlerësues brenda shtatë (7) ditëve pas themelimit të komisionit?	9	47
23.	Në mbledhjen e parë, Komisioni Vlerësues a i ka miratuar rregullat e punës, përmes të cilave do të udhëhiqet puna në komision?	3	16
24.	A janë bërë publike rregullat e punës brenda shtatë (7) ditëve pas miratimit?	1	5
25.	A është siguruar (ZKA) se në proces nuk ka anëtarë të komisionit të emëruar politikë?	5	26

Gjetjet në këtë fushë tregojnë për përmbushje të ndryshme të kritereve nga komunat e monitoruara. **11 komuna (58%)** kanë përcaktuar përbërjen, kohëzgjatjen dhe mandatin e Komisionit Vlerësues me vendim të Zyrtarit Kryesor Administrativ (ZKA). Po ashtu, në **11 komuna (58%)** është përfshirë një përfaqësues nga njësia përkatëse, dy përfaqësues nga grupi i ekspertëve të jashtëm, si dhe njëri prej tyre është përfaqësues i OJQ-ve.

**9 komuna (47%)** kanë zgjedhur anëtarët e Komisionit Vlerësues përmes një thirrjeje publike, kanë themeluar komisionin gjatë kohës kur thirrja publike ka qenë e hapur dhe kanë bërë publik emrat e anëtarëve të Komisionit brenda shtatë ditëve nga themelimi. **7 komuna (37%)** kanë përfshirë dy përfaqësues nga institucioni që ofron mbështetje financiare, ku njëri është nga njësia për buxhet dhe financa.

Në vetëm **3 komuna (16%)**, Komisioni Vlerësues ka miratuar rregullat e punës në mbledhjen e parë, ndërsa në vetëm **1 komunë (5%)**, këto rregulla janë bërë publike brenda shtatë ditëve nga miratimi. Për më tepër, **5 komuna (26%)** kanë siguruar që në proces nuk ka pasur anëtarë të Komisionit të emëruar politikisht. Këto të dhëna tregojnë një nivel të ndryshëm të përmbushjes së indikatorëve mes komunave të monitoruara, me disa indikatorë të përmbushur në mënyrë të kufizuar.

### Komisioni i Ankesave<sup>25</sup>

Në këtë fushë, monitoruesit janë udhëzuar të gjejnë vendimin për Komisionin e Ankesave. Në rastet kur ky vendim nuk është siguruar, disa nga të dhënat janë marrë nga listat preliminare dhe përfundimtare të përfituesve.

Nr.	Indikatorët që vlerësojnë informacionet e raportuara për projektet/programet e mbështetura me fonde publike	Nr. i komunave që i kanë zbatuar indikatorët	Përqindja (%) e komunave që i kanë zbatuar indikatorët
-----	---	--	--

<sup>25</sup> Neni 9 (1 -5)

26.	A e ka themeluar ofruesi i mbështetjes financiare Komisionin e Ankesave?	4	21
27.	A e ka zbatuar Komisioni i Ankesave mandatin të shqyrtojë ankesat ndaj vendimeve për mos kualifikim si rezultat i mos përmbushjes së kriterëve?	3	16
28.	A e ka zbatuar Komisioni i Ankesave mandatin të shqyrtojë ankesat ndaj vendimit për ndarje të mbështetjes financiare, në procesin e përzgjedhjes së përfituesve të mbështetjes financiare?	4	21
29.	Komisioni i Ankesave a përbëhet nga tre (3) anëtarë dhe a ka mandat dyvjeçar?	4	21
30.	Përveç anëtarëve të rregullt të Komisionit të Ankesave, ofruesi i mbështetjes financiare a ka paraparë me vendim edhe një (1) anëtarë rezervë, i cili do të zëvendësojë në rast nevojë anëtarin e komisionit, i cili ka konflikt interesi?	4	21
31.	Përbërja e komisionit a është caktuar me vendim të Zyrtarit Kryesor Administrativ?	4	21
32.	A është parandaluar përfshirja në Komisionin e Ankesave e ndonjë anëtari që ka qenë në kuadrin e Komisionit Vlerësues?	4	21
33.	A është parandaluar përfshirja e të emëruarve politikë në Komisionin e Ankesave?	3	16

Tabela pasqyron numrin e komunave që kanë zbatuar indikatorët për raportimin e informacionit mbi projektet dhe programet e mbështetura me fonde publike, duke u fokusuar te Komisionet e Ankesave. **4 komuna (21%)** kanë themeluar Komisionin e Ankesave dhe kanë zbatuar mandatin për shqyrtimin e ankesave ndaj vendimeve për mos kualifikim për shkak të mos përmbushjes së kriterëve dhe ndaj vendimeve për ndarjen e mbështetjes financiare. Në **4 komuna (21%)**, komisionet janë përbërë nga tre anëtarë me mandat dyvjeçar, dhe ofruesit e mbështetjes financiare kanë parashikuar një anëtar rezervë për të zëvendësuar në rast konflikti interesi.

Gjithashtu, në këto komuna përbërja e Komisionit është caktuar me vendim të Zyrtarit Kryesor Administrativ (ZKA), dhe është parandaluar përfshirja e ndonjë anëtari që ka qenë pjesë e Komisionit Vlerësues. Ndërkohë, vetëm **3 komuna (16%)** kanë siguruar që në Komisionin e Ankesave nuk ka pasur të emëruar politikisht.

## Raportimi/Monitorimi i komunave

### Monitorimi<sup>26</sup>

Në këtë fushë, monitoruesit janë udhëzuar të sigurojnë të dhëna nga raporti vjetor dhe nga tabelat sipas formularit F20 në bazën e të dhënave. Treguesit e monitoruar përfshijnë: rregullsinë e

<sup>26</sup> Neni 2 (2.1 – 2.4), Neni 3 (3.1 – 3.3)

shpenzimit të fondeve publike; monitorimin e realizimit të aktiviteteve dhe të projektit në përgjithësi; rezultatet e arritura nga zbatimi i projektit; ndikimet e projektit; vizitat në terren dhe vlerësimin periodik të projekteve.

Nr.	Indikatorët që vlerësojnë informacionet e raportuara për projektet/programet e mbështetura me fonde publike	Nr. i komunave që i kanë zbatuar indikatorët	Përqindja (%) e komunave që i kanë zbatuar indikatorët
34.	Rregullsinë e shpenzimit të fondeve publike	4	21
35.	Realizimin e aktiviteteve të projektit dhe projektit në tërësi	4	21
36.	Rezultatet e arritura përmes implementimit të projektit	4	21
37.	Ndikimet e projektit	3	16
38.	Për projektet që janë më të gjata se një vit, a është kryer të paktën një vizitë në terren brenda një viti?	3	16
39.	Për projektet me kohëzgjatje më të shkurtër se një vit, a është bërë të paktën një vizitë në terren gjatë zbatimit të projekti?	5	26
40.	Ofruesi i mbështetjes financiare, bazuar në të dhënat e grumbulluara gjatë monitorimit të zbatimit të projekteve dhe programeve të financuara, a ka kryer vlerësimin periodik të mbështetjes së dhënë financiare?	4	21

Tabela paraqet numrin e komunave që kanë zbatuar indikatorët për raportimin e informacionit mbi projektet dhe programet e mbështetura me fonde publike. **4 komuna (21%)** kanë siguruar rregullsinë e shpenzimit të fondeve publike, realizimin e aktiviteteve të projektit dhe projektit në tërësi, rezultatet e arritura nga implementimi, dhe kanë kryer vlerësimin periodik të mbështetjes financiare bazuar në të dhënat e grumbulluara gjatë monitorimit. Sa i përket ndikimeve të projektit dhe vizitave në terren për projektet që zgjasin më shumë se një vit, këto indikatorë janë përmbushur nga **3 komuna (16%)**. Për projektet me kohëzgjatje më të shkurtër se një vit, **5 komuna (26%)** kanë realizuar të paktën një vizitë në terren gjatë zbatimit të projektit.

### Mbledhja dhe administrimi i të dhënave<sup>27</sup>

Për këtë fushë, të dhënat janë siguruar përmes raportit vjetor; kur ky raport ka munguar, janë përdorur formulari F20 në bazën e të dhënave dhe raporti gjithëpërfshirës vjetor. Vlen të theksohet se ka mungesë të raporteve vjetore. Sipas të dhënave në platformën OJQ-financime dhe planit vjetor të financimit, vetëm 21 komuna kanë paraqitur të dhëna për financim.

<sup>27</sup> Neni 25 (1 -2)

Nr.	Indikatorët që vlerësojnë informacionet e raportuara për projektet/programet e mbështetura me fonde publike	Nr. i komunave që i kanë zbatuar indikatorët	Përqindja (%) e komunave që i kanë zbatuar indikatorët
41.	Ofruesi i mbështetjes financiare a ka zbatuar obligimin për të mbledhur dhe administruar të dhënat për mbështetjen financiare publike, gjatë gjithë kohës së zbatimit të projekteve/propozimeve?	3	16
42.	Raportimi i përfituesve a e ka ndjekur formatin e përcaktuar në Rregullore dhe Manual?	3	16
43.	Ofruesi i mbështetjes financiare publike, a ka përgatitur një raport përmbledhës sa i përket projekteve/programeve të financuara nga burimet publike të financimit?	6	32
44.	Ofruesi i mbështetjes financiare, a ka bërë publike në ueb-faqen e tyre një raport përmbledhës sa i përket projekteve/programeve të financuara nga burimet publike të financimit ?	5	26
45.	A janë raportuar në ZQM si dhe a janë publikuar në platformën e financimit të OJQ-ve?	13	68

Treguesit e monitoruar në këtë fushë përfshijnë: mbledhjen dhe administrimin e të dhënave gjatë zbatimit të projekteve, raportimin e përfituesve sipas formatit të përcaktuar në rregullore dhe manual, përgatitjen e raportit përmbledhës të financimit nga ofruesi i mbështetjes financiare, publikimin e raportit në ueb faqe, raportimin në ZQM dhe publikimin në platformën OJQ-financime. Tabela paraqet numrin e komunave që kanë zbatuar indikatorët për raportimin e informacionit mbi projektet dhe programet e mbështetura me fonde publike. **3 komuna (16%)** kanë përmbushur obligimin për të mbledhur dhe administruar të dhënat për mbështetjen financiare publike gjatë zbatimit të projekteve, si dhe kanë ndjekur formatin e raportimit të përcaktuar nga Rregullorja dhe Manuali. **6 komuna (32%)** kanë përgatitur një raport përmbledhës për projektet dhe programet e financuara nga burimet publike, ndërsa **5 komuna (26%)** kanë bërë publik këtë raport në ueb-faqet e tyre.

Ndërkohë, **13 komuna (68%)** kanë raportuar informacionet e mbështetjes financiare në Zyrën e Kryeministrit dhe i kanë publikuar ato në platformën për financimin e OJQ-ve. Rezultatet tregojnë një nivel të ulët zbatimi të indikatorëve në shumicën e komunave, përveç raportimit dhe publikimit në platformën për financimin e OJQ-ve, i cili ka përqindjen më të lartë të përmbushjes.

### Formulari dhe përmbajtja e raportit<sup>28</sup>

Për këtë fushë, fillimisht janë kontrolluar ueb-faqet e komunave për të verifikuar publikimin e raporteve. Në rastet kur raportet nuk janë gjetur, është përdorur formulari nga tabela e bazës së të dhënave sipas F20.

<sup>28</sup> Neni 2 (2.1 – 2.12)

Nr.	Indikatorët që vlerësojnë informacionet e raportuara për projektet/programet e mbështetura me fonde publike	Nr. i komunave që i kanë zbatuar indikatorët	Përqindja (%) e komunave që i kanë zbatuar indikatorët
46.	Emërtimin e projektit/programit apo aktiviteteve të financuara	9	47
47.	Përfituesit e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë	10	53
48.	Fushat e përgjithshme dhe specifike të financimit	11	58
49.	Kohëzgjatjen e projektit dhe statusin e zbatimit të tij	10	53
50.	Thirrjen publike përmes të cilës është ofruar mbështetja financiare	12	63
51.	Emrin e plotë të përfituesve të mbështetjes financiare, duke përfshirë të dhënat tjera të përfituesit, adresën, numrin e regjistrimit, numrin fiskal dhe të dhënat për personin përgjegjës të OJQ-së	10	53
52.	Shumën e dhënë për financimin e projektit/programit	11	58
53.	Mënyrën e alokimit të mbështetjes financiare publike	11	58
54.	Të dhënat gjeografike sa i përket vendit të implementimit të projektit	12	63
55.	Emrin e ofruesit të mbështetjes financiare publike, duke përfshirë programet specifike në kuadër të të cilave ofrohet mbështetja financiare publike	9	47
56.	Numrin e përafërt të personave që kanë përfituar apo janë punësuar në kuadër të projektit/programit	9	47
57.	Aktivitetet kryesore të realizuara në kuadër të projektit	9	47
58.	Raportimi a është bërë sipas formularit përkatës, i cili duhet të plotësohet nga secili ofrues i mbështetjes financiare publike?	3	16

Tabela përmbledh numrin e komunave që kanë zbatuar indikatorët për raportimin e informacionit mbi projektet dhe programet e mbështetura me fonde publike. **9 komuna (47%)** kanë raportuar emërtimin e projektit, emrin e ofruesit të mbështetjes financiare publike, numrin e përafërt të përfituesve ose të punësuarve në projekt, si dhe aktivitetet kryesore të realizuara. **10 komuna (53%)** kanë raportuar përfituesit e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë, kohëzgjatjen e projektit dhe statusin e tij, si dhe emrin e plotë dhe informacionet e tjera për përfituesit e mbështetjes financiare.

**11 komuna (58%)** kanë raportuar fushat e financimit, shumën e dhënë për projektet, dhe mënyrën e alokimit të mbështetjes financiare. **12 komuna (63%)** kanë dhënë informacione mbi thirrjet publike dhe të dhënat gjeografike për vendin e implementimit të projektit. Ndërkohë, vetëm **3 komuna (16%)** kanë kryer raportimin sipas formularit të përcaktuar nga ofruesi i mbështetjes financiare publike.

### Raporti gjithëpërfshirës vjetor i mbështetjes financiare publike për OJQ-të dhe Manuali për Zbatimin e Rregullores

Për këtë fushë, janë vlerësuar indikatorët që lidhen me përgatitjen e raporteve nga ofruesit e mbështetjes financiare; hartimi i raportit të përgjithshëm vjetor nga Zyra e Kryeministrit/Zyra për Qeverisje të Mirë; Publikimi i Raporteve të Hollësishme sipas Formularit F20 (informacionet rreth projekteve apo programeve).

Nr.	Indikatorët që vlerësojnë informacionet e raportuara për projektet/programet e mbështetura me fonde publike	Nr. i komunave që i kanë zbatuar indikatorët	Përqindja (%) e komunave që i kanë zbatuar indikatorët
59.	Ofruesi i mbështetjes financiare publike pasi ka përgatitur raportin vjetor, a e ka dërguar një kopje elektronike të raportit Zyrës së Kryeministrit, përkatësisht Zyrës përkatëse për Qeverisje të Mirë, më së largu deri më 1 mars?	5	26
60.	Zyra e Kryeministrit/Zyra për Qeverisje të Mirë, mbi bazën e raporteve të pranuar nga secili ofrues i mbështetjes financiare publike, a e ka përgatitur raportin e përgjithshëm vjetor të mbështetjes financiare publike për OJQ-të, më së largu deri më 31 mars?	8	42
61.	A janë publikuar listat dhe shumat e organizatave përfituese në platformën e financimit publik të OJQ-ve, nga ofruesi i mbështetjes financiare?	9	47
62.	Raportimi a është bërë sipas formularit përkatës, i cili duhet të plotësohet nga secili ofrues i mbështetjes financiare publike?	14	74

Tabela paraqet numrin e komunave që kanë zbatuar indikatorët për raportimin e projekteve dhe programeve të mbështetura me fonde publike. **5 komuna (26%)** kanë dërguar një kopje elektronike të raportit vjetor Zyrës së Kryeministrit (ZKM) ose Zyrës përkatëse për Qeverisje të Mirë brenda afatit të përcaktuar deri më 1 mars. **8 komuna (42%)** raportojnë se ZKM/Zyra për Qeverisje të Mirë ka përgatitur raportin e përgjithshëm vjetor të mbështetjes financiare publike për OJQ-të brenda afatit deri më 31 mars. Për publikimin e listave dhe shumave të organizatave përfituese në platformën e financimit publik të OJQ-ve, ky indikator është përmbushur nga **9 komuna (47%)**. Ndërkohë, **14 komuna (74%)** kanë realizuar raportimin sipas formularit përkatës, duke shfaqur nivelin më të lartë të përmbushjes për këtë grup indikatorësh.

## REZULTATET

Rezultatet janë paraqitur në formë tabelare për të ofruar një pasqyrë të qartë dhe të organizuar të performancës së komunave dhe ofruesve të mbështetjes financiare. Kjo formë e paraqitjes ndihmon në analizimin e të dhënave dhe në krahasimin e performancës në mënyrë të strukturuar dhe të lehtë për t'u kuptuar.

Tabelat më poshtë përmbajnë të dhëna mbi performancën e komunave në Kosovë, e cila është e ndarë në tri kolona kryesore:

1. **Kriteret e përmbushura nga vlerësimet individuale të komunave** (nga gjithsej 70 kriteret të monitoruara) - Kjo kolonë tregon numrin dhe përqindjen e kriterëve që secila komunë ka përmbushur nga një total prej 70 kriterëve të monitoruara për thirrje.
2. **Përgjegjësitë e përmbushura nga ofruesit e mbështetjes financiare** (nga gjithsej 62 kriteret të monitoruara) - Kjo kolonë tregon numrin dhe përqindjen e kriterëve që ofruesit e mbështetjes financiare kanë përmbushur nga një total prej 62 kriterëve të monitoruara për secilën komunë.
3. **Përmbledhje e kriterëve të përmbushura të komunave** nga gjithsej 70 kriteret nga vlerësimet individuale dhe 62 kriteret nga përgjegjësitë e përmbushura nga ofruesit e mbështetjes financiare;

### Vlerësimet Individuale

Në këtë pjesë të paraqitjes së rezultateve janë marrë parasysh të dhënat primare dhe sekondare të nxjerra nga procesi i monitorimit. Rezultatet janë analizuar duke përdorur një tërësi, të quajtur Totali, për të dhënë një pamje të plotë të përmbushjes së kriterëve të monitoruara. Totali ka për qëllim të ofrojë një pamje më të qartë të performancës dhe përmbushjes së kriterëve nga komunat dhe ofruesit e mbështetjes financiare në bazë të dy llojeve të të dhënash:

- **Të dhënat primare** - kjo përfshin mbledhjen e të dhënave të drejtpërdrejta të prodhuara nga procesi i financimit publik të OJQ-ve, të tilla si (*vendimi i themelimit të komisionit vlerësues, komisionit të ankesave, thirrja publike për OJQ-të dhe ekspertët e jashtëm; procesverbali i komisionit vlerësues dhe komisionit të ankesave; kontratat me përfituesit; raporti i monitorimit; raporti final*). Kjo qasje mundëson një vlerësim të thelluar dhe të detajuar të proceseve dhe praktikave të komunave, duke siguruar një pamje më të qartë dhe të azhurnuar mbi zbatimin e kriterëve të monitoruara.
- **Të dhënat sekondare** - kjo përfshin përdorimin e të dhënave të mbledhura dhe të përpunuara nga burime të ndryshme gjatë zbatimit të procesit të financimit publik, si (*përbërja e komisionit vlerësues në rezultatet preliminare; afati i ankesave në listën preliminare dhe përfundimtare; vlerësimi sipas pikëve apo organizatat e eliminuara apo diskualifikuara mes rezultateve preliminare dhe përfundimtare; informacione mbi monitorimin, kontraktimin dhe raportimin në udhëzuesit e thirrjes*); Kjo qasje, provon të mbledhë informacione nga procesi për të siguruar një vlerësim sa më objektiv të zhvillimit të procesit si dhe nxjerrë konkluzione dhe rekomandime sa më të fokusuara.

## Kriteret e përmbushura nga vlerësimet individuale

Bazuar në monitorimin e 70 kriterëve për thirrje, tabela pasqyron numrin total të kriterëve të përmbushura për secilën komunë. Ky vlerësim ofron një pamje të qartë mbi nivelin e përmbushjes së kriterëve të monitorimit individual, duke identifikuar komunat që kanë përmbushur më shumë kriterë dhe ato që kanë nevojë për përmirësim. Rezultatet tregojnë përkushtimin e komunave në respektimin e standardeve të transparencës dhe përmbajtjes së thirrjeve, duke reflektuar performancën e tyre në proceset e publikimit, menaxhimit dhe vlerësimit të thirrjeve publike.

Një thirrje arrin **100% përmbushje të kriterëve** nëse plotëson të gjitha **70 kriteret** e monitoruara. Kështu, numri total i kriterëve për një komunë varet nga numri i thirrjeve të monitoruara. Për shembull, Vitia, me një thirrje të monitoruar, ka një total prej 70 kriteresh, ndërsa Gjilani, me katër thirrje të monitoruara, arrin në një total prej 350 kriteresh (70 kriterë × 5 thirrje).

	Komuna	Numri i thirrjeve	Numri total i kriterëve	TOTALI Numri i kriterëve të përmbushura	TOTALI Përqindja (%) e kriterëve të përmbushura
1	Viti	1	70	40	57
2	Malishevë	1	70	33	47
3	Dragash	1	70	26	37
4	Graçanicë	1	70	26	37
5	Gjilan	5	350	120	34
6	Podujeva	1	70	21	30
7	Kamenicë	3	210	61	29
8	Lipjan	1	70	19	27
9	Rahovec	2	140	30	21
10	Pejë	1	70	15	21
11	Fushë-Kosovë	4	280	56	20
12	Prishtina	1	70	14	20
13	Suharekë	1	70	13	19
14	Shtime	5	350	57	16
15	Obiliq	3	210	27	13
16	Novobërdë	1	70	0	0

Tabela paraqet përqindjen e kriterëve të përmbushura nga komunat e monitoruara. Vitia kryeson me 57%, pasuar nga Malisheva me 47%, dhe Dragashi dhe Graçanica, secila me 37%. Gjilani ka përmbushur 34% të kriterëve, ndërsa Podujeva ka arritur në 30%, dhe Kamenica me 29%. Lipjani ka përmbushur 27%, ndërsa Rahoveci dhe Peja kanë secila 21%. Fushë-Kosova dhe Prishtina kanë përmbushur nga 19%, Suhareka ka 18%, dhe Shtime ka 16%. Obiliqi ka përmbushur vetëm 13%, ndërsa Novobërda ka përqindjen më të ulët, me 0%.

## Monitorimet Vjetore

### Përgjegjësitë e përmbushura nga ofruesit e mbështetjes financiare

Tabela paraqet rezultatet e procesit të monitorimit për 19 komunat, duke reflektuar numrin total të kritereve të përmbushura nga këto komuna të monitoruara.

	<b>Komuna</b>	<b>Numri i kritereve të përmbushura</b>	<b>Përqindja (%) e kritereve të përmbushura</b>
1	Graçanicë	58	94
2	Obiliq	46	74
3	Rahovec	36	58
4	Viti	36	58
5	Mamushë	34	55
6	Prishtinë	32	52
7	Hani i Elezit	31	50
8	Malishevë	26	42
9	Kamenicë	24	39
10	Novobërdë	18	29
11	Lipjan	17	27
12	Fushë-Kosovë	15	24
13	Ranillug	15	24
14	Gjilan	14	23
15	Suharekë	13	21
16	Pejë	12	19
17	Shtime	7	11
18	Podujevë	6	10
19	Shtërpçë	3	5

Graçanica kryeson me 58 kritere të përmbushura ose 94%, e ndjekur nga Obiliqi me 46 kritere (74%). Rahoveci dhe Vitia ndajnë përqindjen e tretë më të lartë, secila me 36 kritere të përmbushura (58%), ndërsa Mamusha ndjek me 34 kritere (55%). Prishtina ka përmbushur 32 kritere (52%), dhe Hani i Elezit ka arritur 31 kritere (50%). Malisheva ka përmbushur 26 kritere (42%), ndërsa Kamenica ka arritur 24 kritere (39%). Novobërda ka përmbushur 18 kritere (29%), ndërsa Lipjani ndjek me 17 kritere (27%). Fushë-Kosova dhe Ranilluni kanë secila nga 15 kritere të përmbushura (24%), dhe Gjilani ndjek me 14 kritere (23%).

Komunat me përqindjen më të ulët janë Suhareka me 13 kritere (21%), Peja me 12 kritere (19%), Shtimja me 7 kritere (11%), Podujeva me 6 kritere (10%), dhe Shtërpca me vetëm 3 kritere të përmbushura (5%). Rezultatet tregojnë dallime të mëdha në përmbushjen e kritereve mes komunave, me disa që kanë performancë shumë të lartë dhe të tjera që mbeten larg përmbushjes së plotë.

## Renditja e Komunave bazuar në Përbushjen e Kritereve nga Monitorimi Individual dhe Vjetor

Për të ofruar një pasqyrë të qartë dhe përmbledhëse të performancës së komunave në procesin e monitorimit, kjo pjesë e analizës përqendrohet në renditjen e tyre bazuar në numrin total të kritereve të përbushura nga dy fazat e monitorimit: **70 kritere** të vlerësuara përmes monitorimit individual dhe **62 kritere** të vlerësuara përmes monitorimit vjetor. Kjo qasje kombinon rezultatet nga të dy proceset, duke krijuar një bazë të plotë dhe gjithëpërfshirëse për të matur përbushjen e standardeve të kërkuara.

Në analizë janë përfshirë **15 komuna**, të cilat plotësojnë kriterin për të pasur të dhëna të plota nga të dy proceset e monitorimit – individual dhe vjetor. Në këtë analizë nuk janë përfshirë 4 komuna<sup>29</sup> që ishin monitoruar për procesin e financimit publik, pasi nuk ishin pjesë e monitorimit individual, duke qenë se nuk kishin thirrje të disponueshme për t'u monitoruar.

Nr.	Komuna	Kriteret e Përbushur nga Monitorimi Individual (%)	Kriteret e Përbushur nga Monitorimi Vjetor (%)	Totali i kritereve të përbushura 2022 (%)	Totali i kritereve të përbushura 2023 (%)
1	Graçanicë	94%	37%	↓ 51	↑ 66
2	Viti	58%	57%	↓ 27	↑ 58
3	Malishevë	42%	47%	↓ 45	↑ 45
4	Obiliq	74%	13%	↓ 38	↑ 43
5	Rahovec	58%	21%	↓ 32	↑ 40
6	Prishtina	52%	20%	↓ 34	↑ 36
7	Kamenicë	39%	29%	↑ 70	↓ 34
8	Gjilan	23%	34%	↑ 42	↓ 29
9	Lipjan	27%	27%	⇒ 23	⇒ 27
10	Fushë-Kosovë	24%	20%	⇒ 25	⇒ 22
11	Pejë	19%	21%	↑ 32	↓ 20
12	Podujeva	10%	30%	↑ 35	↓ 20
13	Suharekë	21%	19%	↑ 45	↓ 20
14	Novobërdë	29%	0%	↑ 23	↓ 15
15	Shtime	11%	16%	↑ 19	↓ 14

Tabela paraqet përqindjen e kritereve të përbushura nga komunat në monitorimin individual dhe atë vjetor, si dhe totalin e kritereve të përbushura për secilën komunë. **Graçanica** kryeson me një total prej **66%** të kritereve të përbushura, duke arritur **94%** në monitorimin individual dhe **37%** në monitorimin vjetor. **Vitia** ndjek me një total prej **58%**, duke performuar mirë në të dy monitorimet, me përkatësisht **58%** në individual dhe **57%** në vjetor. **Malisheva** renditet e treta me një total prej **45%**, me **42%** në monitorimin individual dhe **47%** në atë vjetor. **Obiliqi** dhe **Rahoveci** kanë përbushur përkatësisht **43%** dhe **40%** të kritereve totale, me rezultate më të larta

<sup>29</sup> Shtërpcë, Ranillug, Mamushë dhe Hani i Elezit.

në monitorimin individual (74% dhe 58%) sesa në atë vjetor (13% dhe 21%). **Prishtina** ka përmbushur **36%** të kriterëve, me **52%** në monitorimin individual dhe **20%** në vjetor, ndërsa **Kamenica** ka arritur një total prej **34%**.

**Gjilani** dhe **Lipjani** kanë përmbushur përkatësisht **29%** dhe **27%** të kriterëve totale, me rezultate të balancuara mes monitorimeve për Lipjanin dhe një përqindje më të lartë nga monitorimi vjetor për Gjilanin. Komunat si **Fushë-Kosova**, **Peja**, dhe **Podujeva** kanë përmbushur **20%-22%** të kriterëve, ndërsa **Suhareka** dhe **Novobërda** kanë përmbushur **20%** dhe **15%**, përkatësisht. **Shtime** ka përmbushur përqindjen më të ulët të kriterëve, me vetëm **14%** në total, duke performuar dobët në të dy monitorimet. Rezultatet tregojnë dallime të dukshme midis komunave në përmbushjen e kriterëve dhe identifikojnë ato fusha ku nevojiten përmirësime të mëtejshme.

Gjetjet e Auditimit Financiar 2023 dhe Rekomandimet 2022<sup>30</sup>

Nr.	Komuna	Thekset kryesore 2023 <sup>31</sup>	Rekomandimet 2022
1	Deçan	-	Kryetari duhet të sigurojë që subvencionimi i OJQ-ve bëhet përmes thirrjes publike dhe të lidhë marrëveshje me përfituesit. (i zbatuar)
2	Gjakovë	-	-
3	Glllogoc	Pagesa direkte nga thesari për paga jubilarë dhe shujta nga kategori ekonomike jo e duhur, duke mos planifikuar këto shpenzime në buxhet.	-
4	Gjilan	-	Kryetari duhet të hartojë planin vjetor për mbështetjen e OJQ-ve. (i zbatuar)
5	Dragash	-	-
6	Istog	-	-
7	Kaçanik	-	-
8	Klinë	-	-
9	Fushë-Kosovë	Financim i projekteve të OJQ-ve pa thirrje publike për disa projekte. Subvencionimi i individëve në kundërshtim me rregulloren komunale për subvencione.	Kryetari duhet të sigurojë planifikim dhe respektim të kriterëve për financimin e OJQ-ve. (nuk ka filluar zbatim)
10	Kamenicë	Keq klasifikim i shpenzimeve në kategori ekonomike.	-
11	Mitrovicë e Jugut	-	-
12	Leposaviq	-	-
13	Lipjan	Mangësi në përzgjedhjen, monitorimin dhe raportimin nga përfituesit e subvencioneve.	Kryetari duhet të sigurojë një plan vjetor për mbështetje financiare për OJQ-të, në përputhje me rregulloren. (i zbatuar)

<sup>30</sup> <https://1drv.ms/b/c/ba896cdf533e7184/ETxT7QCRd0IMj6AEM5ZpicBysEK0T8hLGQrt7eQofl0pQ?e=wVnbcx> (te dhënat e përmbledhura nga Raportet e Auditimit Financiar – kategoria e subvencioneve)

<sup>31</sup> Për tabelat e zbrazëta, nuk ka pasur gjetje në vitin 2023, apo rekomandime nga viti 2022.

14	Novobërdë	Keq klasifikim i shpenzimeve për shërbimet e zjarrfikësve. Subvencionimi i OJQ-ve pa thirrje publike.	-
15	Obiliq	Raportim i pamjaftueshëm nga përfituesit e subvencioneve. Keq klasifikim i shpenzimeve në kategori ekonomike.	Kryetari duhet të sigurojë respektimin e rregullores për subvencionimin e OJQ-ve. (i zbatuar)
16	Rahovec	-	-
17	Pejë	Dobësi në menaxhimin e subvencioneve, përfituesit nuk kanë dorëzuar raporte financiare dhe narrative për vitin 2023.	Kryetari duhet të caktojë zyrtar përgjegjës për monitorimin e projekteve dhe të kërkojë raporte narrative. (nuk ka filluar zbatimin)
18	Podujevë	-	-
19	Prishtinë	Subvencionimi i OJQ-ve pa thirrje publike për pesë projekte. Shfrytëzim i fondeve për qëllime jo të përcaktuara për subvencionet e dhëna.	Kryetari duhet të sigurojë respektimin e rregullores dhe të kërkojë raporte financiare dhe narrative nga përfituesit. (nuk ka filluar zbatimin)
20	Prizren	Keqklasifikim i shpenzimeve në kategori jo të përshtatshme për projekte të ndryshme.	Kryetari duhet të sigurojë që komisionet e vlerësimit përdorin kritere dhe formularë zyrtarë për subvencionet. (i zbatuar)
21	Skenderaj	-	-
22	Shtime	-	Kryetari duhet të përgatisë planin vjetor për mbështetje financiare për OJQ-të dhe ta dërgojë në Zyrën e Kryeministrit. (i zbatuar)
23	Shtërpcë	-	-
24	Suharekë	-	Kryetari duhet të sigurojë respektimin e kritereve ligjore për aplikim dhe vlerësim për fondet publike. (i zbatuar)
25	Ferizaj	Financim i OJQ-ve pa thirrje publike, përmes një memorandumi për financim projektësh arsimore.	Kryetari duhet të sigurojë planifikimin dhe vlerësimin transparent për dhënien e subvencioneve. (i zbatuar)
26	Viti	-	-

27	Vushtrri	Mungesë e Planit Vjetor për mbështetje financiare për OJQ-të.	Kryetari duhet të përgatisë Planin Vjetor për mbështetje financiare për OJQ-të. (nuk ka filluar zbatimin)
28	Zubin Potok	-	-
29	Zveçan	-	Kryetari duhet të ndërmarrë hapa në përputhje me Rregulloren për financimin publik të OJQ-ve dhe raportimin e fondeve. (i zbatuar)
30	Malishevë	-	-
31	Junik	-	-
32	Mamushë	-	-
33	Hani i Elezit	-	Kryetari duhet të sigurojë përdorimin e formularëve standard të vlerësimit për subvencione dhe përbërja e komisionit të jetë sipas rregullores. (i zbatuar)
34	Graçanicë	Keqklasifikim i shpenzimeve në kategori ekonomike për aktivitete sportive dhe kulturore.	-
35	Ranillug	-	-
36	Partesh	Mungesa e Planit për subvencionimin e OJQ-ve për vitin 2023.	-
37	Klllokot	-	-
38	Mitrovicë e Veriut	-	-

## Konkluzionet

Të përgjithshme	Të ndërthurura	Specifike
<p>Ekziston një mospërputhje mes planifikimit të financimit publik të OJQ-ve, thirrjeve për financim dhe raportimit gjithëpërfshirës.</p>	<p>Vlerësohet se komunat kanë pasur probleme në raportim duke bërë raportime të dyfishta apo edhe raportimin e financimeve që nuk parashihen në rregullore. Raportimi i dyfishtë dhe përfshirja e financimeve që nuk parashihen në rregullore mbeten sfida serioze për komunat. Këto praktika jo vetëm që cenojnë integritetin e procesit të raportimit, por gjithashtu krijojnë paqartësi në pasqyrimin e financimeve reale.</p>	<p>Përderisa, vetëm 22 nga 38 komunat kanë paraqitur planifikim të financimit publik, janë gjetur thirrjet në 23 komuna dhe janë arritur të monitorohen (hapen thirrjet) në ueb-faqe në 16 komuna<sup>32</sup>. Ndërkaq, në platformën e OJQ-financimeve, në raportin gjithëpërfshirës vjetor, kanë paraqitur financime 31 komuna<sup>33</sup>.</p>
<p>Ka pasur sfida sa i përket planifikimit të financimit publik të OJQ-ve; Megjithatë, është rritur numri i komunave në 22 nga 38 komunat që kanë planifikuar, krahasuar nga viti 2022, ku ishin vetëm 19 nga 38.</p>	<p>Konfirmohet në disa raste nga të gjeturat e auditorit, se komunat kanë kryer financime pa pasur plan të financimit publik.</p>	<p>Në 4 komuna janë gjetur thirrje për financim edhe pse nuk kanë paraqitur planifikim. Ndërkaq, kanë raportuar financim gjithsej 11 komuna që nuk kanë planifikuar financim. Është përmirësuar qasja në përkrahimin e fushave dhe objektivave të thirrjeve publike, ku na te dhënat primare<sup>34</sup> janë gjetur 30 nga 32 thirrje (94%) krahasuar me vitin 2022<sup>35</sup>, kur kjo fushë ishte vlerësuar me 81 % apo 45 nga 56 thirrjet e monitoruara;</p>

<sup>32</sup> Nga 21 komuna: 4 komuna kane publikuar thirrje edhe pse nuk ka planifikuar financim ne planin vjetor (Peja, Gjilani, Malisheva dhe Shtimja), ndërkaq në në 10 komuna që kanë planifikuar financim, kanë publikuar thirrjet, por nuk kanë qenë të qasshme në periudhën e monitorimit, si pasojë e problemeve me ueb-faqet (Prizren, Ferizaj, Istog, Skenderaj, Klinë, Glogoc, Hani i Elezit, Kaçanik, Mitrovice e Jugut, Partesh); Prej tyre, Zyra për Informim e Komunës së Klinës, ka dërguar edhe linqet e thirrjeve dhe dokumentet përcjellëse, por si rezultat i problemeve në ueb-faqe, nuk ka pasur qasje për monitorim;

<sup>33</sup> 16 komunat qe nuk kane planifikuar financim,

<sup>34</sup> Udhëzuesi për Aplikim;

<sup>35</sup> Shpallja e thirrjes publike apo njoftimi;

Ka vazhduar financimi i shërbimeve apo edhe kontraktimeve nëpërmjet financimit publik të OJQ-ve.	Si rezultat i kufizimeve për pagesa nga kategoria subvencione për entitetet jopublike si dhe specifikat e statusit, ka pasur një numër të konsiderueshëm të financimeve të kësaj natyre.	Një numër i konsiderueshëm i shpenzimeve për bashkësitë fetare, kontratat e shërbimeve sociale, apo anëtarësitë janë kryer nga kategoria e subvencioneve, dhe raportuar sipas rregullores.
Si rezultat i mosfunksionimit të ueb-faqeve, ka pasur sfida në gjetjen e vendimeve për Komisionin Vlerësues dhe të Ankesave si dhe në thirrjet për përfaqësuesit e OJQ-ve dhe ekspertët.	Mbetet problematike forma e pagesave për ekspertët e angazhuar në vlerësimin e aplikacioneve të financimit publik të OJQ-ve; Si dhe ka hezitim nga OJQ-të për t'u bërë pjesë e Komisionit Vlerësues, ngase humbin mundësitë për aplikime.	Kanë vazhduar problemet në gjetjen e vendimeve të komisioneve vlerësuese dhe të ankesave, për këtë janë përdorur të dhëna dytësore, duke kërkuar listën e anëtarëve të komisionit vlerësues dhe të ankesave (në listat preliminare dhe përfundimtare të përfituesve).
Publikimet e dokumentacionit të prodhuar nga financimet publike vazhdojnë të mbesin të mangëta përfshirë listat sipas pikëve, procesverbalet dhe raportet e financimit (përfshirë edhe monitorimin).	Udhëzimi Administrativ për Administratë të Hapur <sup>36</sup> , ka qartësuar se duhet publikuar të gjitha dokumentet e prodhuara nga financimet publike të OJQ-ve.	Publikimi i listave me pikë (deri 50 pikë, ato që nuk kanë kaluar pragun) dhe (deri 100 pikë vlerësimi); publikimi i procesverbaleve (të komisionit vlerësues dhe ankesave), (raporti final, përfshirë monitorimi)
Ueb-faqet kanë vazhduar të kenë probleme si në qasje, navigim dhe gjetjen e dokumenteve.	Konfirmohet nga Raporti për Vlerësimin e Transparencës së Komunave (2023), se ueb-faqet e komunave kanë pasur probleme.	Si rezultat i problemeve në ueb-faqe, në 7 komuna edhe pse janë gjetur thirrjet monitoruesit nuk kanë arritur të kenë qasje në dokumentacion për të kryer monitorimin.
Në aspektin procedural, ka pasur përparim të theksuar sa i përket transparencës, megjithatë sfida mbeten takimet dhe kthimi i informacionit (përgjigjeve).	Komunat, në veçanti njësitet që kanë planifikuar financim, nuk kanë kapacitete njerëzore për mbajtjen e takimeve informuese dhe kthimin dhe publikimin e përgjigjeve.	Nga monitorimi, del se format kryesore të informimit mbeten publikimi i thirrjeve si dhe format tjera të informimit nga mediat sociale, megjithatë, kanë mbetur në nivele të ulëta takimet informuese si dhe publikimi i përgjigjeve për çështjet e adresuara gjatë procesit të aplikimit. Duhet theksuar se Komuna e Prishtinës ka ndërtuar një

<sup>36</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=84864> (duhet pasur parasysh, se ky udhëzim administrativ nuk ka mbuluar vitin 2023, ngase ka hyrë në fuqi më 21.12.2023);

		platformë të aplikimit online në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit <sup>37</sup> .
Sa i përket vlerësimit procedural dhe përmbajtjesor, vazhdon të mbetet problematik publikimi i procesverbaleve.	Të dhënat për këtë fushë, kryesisht janë mbledhur nga të dhënat sekondare (duke krahasuar listat preliminare dhe përfundimtare të përfituesve).	Publikimi i listave të përfituesve, nuk bëhet sipas vlerësimit deri në 100 pikë, dhe diskualifikimit nën 50 pikë. Po ashtu, nuk publikohet lista e plotë sipas pikëve dhe arsyetimet për diskualifikim procedural.
Lidhja e kontratave mes ofruesve të financimit publik (komunave) dhe OJQ-ve dhe dokumentacioni i kërkuar.	Të gjeturat e auditimit vendosin në pah se në disa raste ka munguar dokumentacioni që parashihet në rregullore për lidhjen e kontratave.	Ekzistojnë ende paqartësi procedurale sa i përket dokumentacionit të kërkuar për lidhjen e kontratave me përfituesit.
Monitorimi i financimit publik të OJQ-ve, ka vazhduar të mbetet pika më problematike e procesit.	Të gjeturat e auditimit vendosin në pah mungesën e procedurave standarde për monitorim, caktimin e zyrtarëve për monitorim si dhe mungesën e dëshmive për pagesat e kryera.	Procesi i monitorimit të financimit publik të OJQ-ve, del të jetë i sfiduar nga mungesa e zyrtarëve përgjegjës për monitorim, mungesa e procedurave standarde të monitorimit si dhe mangësitë në njohjen e procedurave të përcaktuara nga rregullorja.
Raportimi i përfituesve, raportimi nga komuna si dhe raporti gjithëpërfshirës vjetor.	Evidentohet nga të gjeturat e auditimit se ka ende probleme në raportimin e financimeve nga organizatat por edhe në hartimin e raporteve vjetore.	Përkundër se rregullorja ka paraparë kornizat e raportimit si dhe formularët e raportimit, problematike mbetet monitorimi i raportimeve të përfituesve. Ndërkaq, sa u përket raporteve vjetore, komunat nuk kanë ndërtuar ndonjë format të standardizuar që i vlerësojnë të gjitha fazat e financimit publik të OJQ-ve. Përderisa, sa i përket raportit gjithëpërfshirës vjetor, si rezultat i pengesave në platformë, në disa raste ka raportime të dyfishta të vlerave financiare.

<sup>37</sup> <https://krs.prishtinaonline.com/>

## Rekomandimet

Të përgjithshme	Të ndërthurura	Specifike
<p><b>Të përmirësohet cikli i financimeve publike për OJQ-të:</b> Rekomandohet që komunat të hartojnë plane të shtirjes për të ndjekur dhe vlerësuar secilën halkë të procesit.</p>	<p>Raporti për Vendin i Komisionit Evropian (2024) thekson se Kosova ka ndërmarrë veprime specifike për rritjen e transparencës</p> <p>dhe llogaridhënien e financimit publik për OShC-të, por sfidat mbeten në raportim dhe</p> <p>vlerësimi i efektivitetit të fondeve të alokuara<sup>38</sup></p>	<p>Të përmirësohet sistematikisht cikli i financimeve publike të OJQ-ve, nisur nga planifikimi i financimit (konsultimit me shoqërinë civile dhe ndethurja e objektivave mbi analizë dhe dokumente strategjike/programe komunale); Procesi i Shpalljes së Thirrjeve (të përmirësohet në veçanti takimet informuse/kthimi i përgjigjeve) Vlerësimi (të avancohet procesi i vlerësimit në veçanti atij përmbajtësor, duke shtuar edhe kapacitet e brendshme, nivelin e ekspertizës dhe përfaqësimit të shoqërisë civile); Monitorimi dhe Raportimi (vlerësimi i arritje së rezultateve, vlerësimi i ndikimit është komponenti kyc që duhet përmirësuar; ashtu sikurse edhe nxjerrja e raporteve që dokumentojnë efektivitetin e fondeve të alokuara)</p>
<p><b>Të përfshihen të gjitha thirrjet në platformën OJQ-financime:</b> Rekomandohet që të gjitha thirrjet për financim të përfshihen në platformë dhe të krijohet një seksion i veçantë në ueb-faqet</p>	<p>Të përmirësohet vizibiliteti në financimin komunal, duke hartuar udhëzues dhe shpërndarë ata me OJQ-të.</p>	<p>Të përmirësohen kapacitet e zyrtarëve komunalë për të ofruar udhëzime të qarta të përshtatura me natyrën e thirrjes dhe kontekstin.</p>

<sup>38</sup> [https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/c790738e-4cf6-4a43-a8a9-43c1b6f01e10\\_en?filename=Kosovo%20Report%202024.pdf](https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/c790738e-4cf6-4a43-a8a9-43c1b6f01e10_en?filename=Kosovo%20Report%202024.pdf)

e komunave ose njësive përkatëse të mbështetjes financiare		
<p><b>Të ndërtohet një kornizë për transparencë dhe llogaridhënie:</b> Komunat duhet të krijojnë një kornizë dokumentesh që lidhen me transparencën dhe llogaridhënien në financimin publik për OJQ-të, përfshirë krijimin e një seksioni të veçantë në ueb-faqet komunale.</p>	Rekomandohet të definohet publikimi i të dhënave, duke marrë parasysh obligimet për transparencë, llogaridhënie dhe mbrojtjen e të dhënave personale.	T'u shtohet listave preliminare dhe përfundimtare poentimi deri në 100 pikë, diskualifikimi deri në 50 pikë dhe lista e plotë e renditur sipas pikëve.
<p><b>Të adresohet ngritja e kapaciteteve të OJQ-ve:</b> Përveç ndarjes së financimeve, komunat duhet të mbështesin procesin e ngritjes së kapaciteteve të OJQ-ve lokale. Kjo përfshin zhvillimin e platformave dhe agjendave të përbashkëta, ofrimin e hapësirave të punës, mbështetje teknike dhe logjistike, si dhe përfshirjen e OJQ-ve në proceset e bashkë-krijimit të politikave lokale.</p>	Të shtohen tabelat në mes raportit të hollësishëm sipas formularit F20, ku mund të gjenden të dhëna lidhur me procesin e zbatimit dhe monitorimit të projekteve të financuara.	Të përmirësohet procesi i ndërlidhjes së thirrjeve me dokumentet strategjike komunale, të shmangen praktikat aktuale të shkurtimeve të fondeve pa ri-programuar objektivat e aplikimit, të qartësohet në fazën e hershme procesi i monitorimit dhe raportimit
<p><b>Të adoptohen praktikat e mira:</b> Komunat duhet të adoptojnë praktikat më të mira nga bashkë-financimet dhe menaxhimi i procesit të financimit nga organizatat dhe donatorët.</p>	Rekomandohet që komunat bashkë me organizatat të ndërtojnë një plan të shtrirjes nga procesi i konsultimeve e deri te monitorimi dhe raportimi.	Duhet të rritet ndjeshëm transparencja në vlerësimin e ankesave dhe përgjithësisht të definohet cikli nga aplikimi deri tek shpallja e listave përfundimtare.

<p><b>Të qartësohen procedurat financiare:</b> Zyrtarët Kryesor Financiar duhet të sigurojnë që njësitë përkatëse/drejtoritë të kenë dokumente të qarta për lidhjen e kontratave dhe procedurat e raportimit financiar.</p>	<p>Raportet e Auditorit Rekomandojnë që të përmirësohet zbatimi i rregullores për financim publik të OJQ-ve në fokus në dokumentacionin e kërkuar për lidhjen e kontratave (dëshmitë që nuk ka borxhe në ATK, formulari i deklarimit të financimit të dyfishtë, pagesat e kontributeve) e poashtu vendos thekset tek dokumentacioni i kërkuar për raportim (dorëzimi i raportit narrativ dhe financiar/bashkë me dëshmitë)</p>	<p>Zyrtarët Kryesor Financiar, duhet të ndërtojnë një kornizë të dokumenteve që kërkohen sa i përket kërkesave ligjore për dokumentacion si dhe pjesën e raportimit financiar;</p>
<p><b>Të sigurohet vlerësimi i rregullt:</b> Zyrtarët Kryesor Administrativ dhe drejtoritë që ofrojnë financime publike për OJQ-të duhet të sigurohen që komisioni vlerësues të përdorë procedurat e vlerësimit siç parashikohen në rregullore.</p>	<p>Raportet e Auditorit Rekomandojnë që të sigurohet shmangja e konfliktit të interesit mes komisionit dhe përfituesve, e njëkohësisht të rritet niveli (ekspertiza) për komisioni vlerësues në zbatimin e rregullores për financim publik të OJQ-ve;</p>	<p>Zyrtarët Kryesor Financiar dhe njësia/drejtoria që ofron financim publik të OJQ-ve, duhet të sigurohet për shmangien e konfliktit të interesit të komisionit vlerësues, e njëkohësisht të (informojë/konsultoi) komisionin vlerësues para nisjes së vlerësimit për format e vlerësimit dhe përdorimin e formularëve siç përcaktohen në rregullore;</p>
<p><b>Të përmirësohen proceset e monitorimit dhe raportimit:</b> Komunitat duhet të forcojnë mekanizmat e monitorimit dhe raportimit, duke përfshirë publikimin e raporteve komunale dhe raportit përmbledhës vjetor.</p>	<p>Domosdoshmëria e standardizimi i praktikave të raportimit dhe rritja e mbikëqyrjes për të siguruar që raportet të jenë të sakta, të qarta dhe në përputhje me rregulloret përkatëse. Kjo do të kontribuonte një procesi transparent dhe llogaridhënës.</p>	<p>Të ndërtohet një kornizë e qartë e raportimit që përmbledhë të dhënat e kërkuara sipas udhëzimit administrativ dhe manualit. Poashtu, rekomandohet që komunitat të hartojnë metodologji për të matur rezultatet e arritura nga thirrja publike.</p>

<p><b>Të zhvillohen kapacitetet për monitorim:</b> Duhet të forcohen kapacitetet e komunave për monitorim dhe raportim efektiv.</p>	<p>Të ngritën kapacitetet e zyrtarëve komunalë, në proceset e monitorimit si dhe në hartimin e raporteve që lidhen me financimin publik të OJQ-ve.</p>	<p>Të përkrahen komunat me asistencë profesionale në procesin e planifikimit të financimit të OJQ-ve (rekomandim nga ZKA).</p>
---	--	--

## ANEKSET

### Aneksi 1 - Tabela e Kritereve - Vlerësimet Individuale

<b>Nr.</b>	<b>Indikatorët që vlerësojnë shpalljen publike në thirrjet e publikuara</b>
1.	Publikimi i thirrjes në ueb-faqen e komunës
2.	Përdorimi i forma tjera të informimit me qëllim të rritjes së konkurrueshmërisë
3.	Thirrja ka qenë hapur së paku (15) ditë pune
4.	Zgjatja e afatit të thirrjes përtej (15) ditë pune
5.	Ofrimi i mundësisë për sqarime shtesë përmes postës elektronike (e-mail)
6.	Sqarime dhe përgjigje me shkrim, dhe të njëjtat a janë publikuar në ueb-faqe së paku (8) ditë para mbylljes së thirrjes

<b>Nr.</b>	<b>Indikatorët që vlerësojnë publikimin e thirrjes në ueb-faqen e komunës në thirrjet e publikuara</b>
7.	Udhëzimet
8.	Formulari i projektit
9.	Formulari i buxhetit
10.	Lista e dokumenteve
11.	Afatet (hapja/mbyllja)
12.	Mënyra e aplikimit

<b>Nr.</b>	<b>Indikatorët që vlerësojnë përmbajtjen e udhëzimeve për aplikantët në thirrjet e publikuara</b>
13.	Përshkrimi i problemit
14.	Objektivat e thirrjes
15.	Përshkrimi i fushave

16.	Numri i përafërt i kontratave
17.	Shuma e mjeteve financiare
18.	Shumat më të ulëta/ larta - numri i projekteve
19.	Kohëzgjatja
20.	Organizatrat që kualifikohen
21.	Parimet prioritare
22.	Aktivitetet e kualifikuara
23.	Shpenzimet e pranueshme/të papranueshme
24.	Dokumentacioni i detyrueshëm dhe jo i detyrueshëm për aplikim
25.	Data e hapjes/mbylljes
26.	Paraqitja e adresës
27.	Kushtet dhe mënyra e parashtrimit të pyetjeve
28.	Mënyra e publikimit të përgjigjeve
29.	Kushtet dhe mënyra e paraqitjes së ankesave
30.	Informacioni mbi kontraktimin
31.	Procedura për monitorim si dhe metoda dhe përmbajtja e raportimit
32.	Paraqitja e kalendarit tentativë për zbatimin të procedurës së thirrjes
33.	Korrigjimet e thirrjeve
34.	Mundësia për ndryshimeve nga aplikantët

<b>Nr.</b>	<b>Indikatorët që vlerësojnë mënyrën e aplikimit në thirrjet e publikuara</b>
35.	Aplikimi përmes e-mailit
36.	Formati i dokumentacionit
37.	Aplikimi në platforma elektronike
38.	Adresa dhe afati i aplikimit

Nr.	Indikatorët që vlerësojnë aplikacionet nga aspekti procedural në thirrjet e publikuara
39.	Pasqyrimi i komunave që janë gjetur të dhëna mbi procesin e vlerësimit
40.	Vlerësimi i aplikacioneve nga aspekti procedural

Nr.	Indikatorët që vlerësojnë publikimin e thirrjes në ueb-faqen e komunës në thirrjet e publikuara
41.	Poentimi deri në 100 pikë
42.	Diskualifikimi i aplikantëve nën 50 pikë
43.	Numri i të listuarve sipas pikëve

Nr.	Indikatorët që vlerësojnë kërkesat për dëshmi të Komisionit Vlerësues për aplikantët e përzgjedhur në thirrjet e publikuara
44.	Dëshmitë e obligimeve tatimore
45.	Statusi i përfitimit publik
46.	Dëshmi se nuk janë në procedurë të shuarjes
47.	Dëshmi se nuk janë në procedurë të çregjistrimit
48.	Deklarata vjetore tatimore
49.	Shqyrtimi i aplikacioneve në listën e pritjes
50.	Përmbyllja e afatit të ankesave për shpalljen e rezultateve

Nr.	Indikatorët që vlerësojnë afatet dhe procedurat e paraqitjes dhe shqyrtimit të ankesave në thirrjet e publikuara
-----	--

51.	Ankesat për aspektin procedural
52.	Ankesat për financim
53.	Vendimi brenda 5 ditëve i komisionit
54.	Ndarja e vendimit me palët
55.	Publikimi i procesverbalit nga Komisioni i Ankesave

<b>Nr.</b>	<b>Indikatorët që vlerësojnë kontratat me përfituesin në thirrjet e publikuara</b>
56.	Lidhja e kontratës brenda 90 ditësh
57.	Shuma e financimit/periudha e zbatimit/monitorimi i zbatimit/raportimi
58.	Dispozita për qëllimin e mbështetjes financiare dhe ndalimin e përdorimit për qëllime tjera
59.	Dispozita e shpenzimit të mjeteve financiare përmes transaksioneve bankare sipas ligjit në fuqi
60.	Dispozita për mënyrën dhe afatet e pagesave dhe shumën e paradhënies
61.	Dispozita mbi shmangien e konfliktit të interesit
62.	Dispozita mbi shkëputjen e kontratës
63.	Dispozita mbi kthimin e mjeteve në rast të shkëputjes të kontratës

<b>Nr.</b>	<b>Indikatorët që vlerësojnë monitorimi dhe raportimi i projekteve/programeve</b>
64.	Caktimi i zyrtarit për monitorim
65.	Raportimi tek zyrtari/ekipi monitorues
66.	Evidentimi i shkeljeve

67.	Raportimi i zyrtarit/ekipit monitorues te ZKA-ja
68.	Shkëputje e kontratave për shkelje të rënda
69.	Vendim për anulimin e kontratës
70.	Masa për iniciimin e procedurave gjyqësore

Aneksi 2 - Tabela e Kritereve - Monitorimet Vjetore

Nr.	Indikatorët që vlerësojnë informacionet e raportuara për projektet/programet e mbështetura me fonde publike
1.	A ka krijuar kod të veçantë ekonomik Ministria e Financave për organizatën buxhetore?
2.	A është planifikuar mbështetja financiare në kuadër të buxhetit vjetor, në linjë me objektivat strategjike dhe në konsultim me shoqërinë civile?
3.	A i ka plotësuar kushtet organizata buxhetore të parapara në 1.1.1 dhe 1.1.2, për të ofruar mbështetje financiare për OJQ-të?
4.	A është përgatitur plani vjetor i mbështetjes financiare, më së largu 30 ditë pas miratimit të buxhetit vjetor?

Nr.	Indikatorët që vlerësojnë informacionet e raportuara për projektet/programet e mbështetura me fonde publike
5.	Informata për organizatën buxhetore
6.	Shumën e mbështetjes financiare për vitin fiskal
7.	Fushën/fushat në të cilat do të ofrohet mbështetja financiare për OJQ
8.	Objektivat e mbështetjes financiare
9.	Numrin e përafërt të organizatave që do të përfitojnë
10.	Kohën e hapjes së thirrjes për aplikime
11.	Kohën e përafërt të fillimit të zbatimit të projekteve/programeve përfituese
12.	A e ka publikuar institucioni përkatës pjesën e vetë të planit vjetor të mbështetjes financiare për OJQ-të, më së largu 45 ditë pas miratimit të buxhetit ?
13.	A e ka përgatitur Zyra e Kryeministrit planin përmbledhës vjetor të mbështetjes financiare për OJQ-të, më së largu pas 45 ditëve pas miratimit të buxhetit të Republikës së Kosovës?
14.	A e ka publikuar ZQM-ja planin përmbledhës vjetor të mbështetjes financiare për OJQ-të në faqen e saj elektronike?

Nr.	Indikatorët që vlerësojnë informacionet e raportuara për projektet/programet e mbështetura me fonde publike
15.	A është përcaktuar përbërja, kohëzgjatja dhe mandati i komisionit, me vendim të zyrtarit kryesor administrativ?

16.	A është përfshirë një (1) përfaqësues nga njësia përkatëse, në kuadër të së cilës është planifikuar mbështetja financiare?
17.	A janë përfshirë dy (2) përfaqësues nga grupi i ekspertëve të jashtëm?
18.	A është njëri nga ta përfaqësues i OJQ-ve?
19.	A janë zgjedhur përmes një thirrje publike të cilën do ta bëjë ofruesi i mbështetjes financiare?
20.	A janë përfshirë dy (2) përfaqësues nga institucioni që ofron mbështetjen financiare, njëri nga të cilët duhet të jetë nga njësia përkatëse për buxhet/financa?
21.	A është themeluar Komisioni Vlerësues gjatë kohës sa thirrja publike është e hapur?
22.	A janë bërë publik emrat e anëtarëve të Komisionit Vlerësues brenda shtatë (7) ditëve pas themelimit të Komisionit?
23.	Në mbledhjen e parë, Komisioni Vlerësues a i ka miratuar rregullat e punës, përmes të cilave do të udhëhiqet puna në komision?
24.	A janë bërë publike rregullat e punës brenda shtatë (7) ditëve pas miratimit?
25.	A është siguruar (ZKA) se në proces nuk ka anëtarë të komisionit të emëruar politikë?

<b>Nr.</b>	<b>Indikatorët që vlerësojnë informacionet e raportuara për projektet/programet e mbështetura me fonde publike</b>
26.	A e ka themeluar ofruesi i mbështetjes financiare Komisionin e Ankesave?
27.	A e ka zbatuar Komisioni i Ankesave mandatin të shqyrtojë ankesat ndaj vendimeve për mos kualifikim si rezultat i mos përmbushjes së kritereve?
28.	A e ka zbatuar Komisioni i Ankesave mandatin të shqyrtojë ankesat ndaj vendimit për ndarje të mbështetjes financiare, në procesin e përzgjedhjes së përfituesve të mbështetjes financiare?
29.	Komisioni i Ankesave a përbëhet nga tre (3) anëtarë dhe a ka mandat dyvjeçar?
30.	Përveç anëtarëve të rregullt të Komisionit të Ankesave, ofruesi i mbështetjes financiare a ka paraparë me vendim edhe një (1) anëtarë rezervë, i cili do të zëvendësojë në rast nevojë anëtarin e komisionit, i cili ka konflikt interesi?
31.	Përbërja e komisionit a është caktuar me vendim të Zyrtarit Kryesor Administrativ?
32.	A është parandaluar përfshirja në Komisionin e Ankesave e ndonjë anëtarë që ka qenë në kuadrin e Komisionit Vlerësues?
33.	A është parandaluar përfshirja e të emëruarve politikë në Komisionin e Ankesave?

<b>Nr.</b>	<b>Indikatorët që vlerësojnë informacionet e raportuara për projektet/programet e mbështetura me fonde publike</b>
34.	Rregullsinë e shpenzimit të fondeve publike
35.	Realizimin e aktiviteteve të projektit dhe projektit në tërësi
36.	Rezultatet e arritura përmes implementimit të projektit
37.	Ndikimet e projektit.
38.	Për projektet që janë më të gjata se një vit, a është kryer të paktën një vizitë në terren brenda një viti?
39.	Për projektet me kohëzgjatje më të shkurtë se një vit, a është bërë të paktën një vizitë në terren gjatë zbatimit të projekti?
40.	Ofruesi i mbështetjes financiare, bazuar në të dhënat e grumbulluara gjatë monitorimit të zbatimit të projekteve dhe programeve të financuara, a ka kryer vlerësimin periodik të mbështetjes së dhënë financiare?

<b>Nr.</b>	<b>Indikatorët që vlerësojnë informacionet e raportuara për projektet/programet e mbështetura me fonde publike</b>
41.	Ofrues i mbështetjes financiare a ka zbatuar obligimin për të mbledhur dhe administruar të dhënat për mbështetjen financiare publike, gjatë gjithë kohës së zbatimit të projekteve/propozimeve?
42.	Raportimi i përfituesve a e ka ndjekur formatin e përcaktuar në Rregullore dhe Manual?
43.	Ofruesi i mbështetjes financiare publike a ka përgatitur një raport përmbledhës sa i përket projekteve/programeve të financuara nga burimet publike të financimit?
44.	Ofruesi i mbështetjes financiare a ka bërë publike në ueb faqen e tyre një raport përmbledhës sa i përket projekteve/programeve të financuara nga burimet publike të financimit ?
45.	A janë raportuar në ZQM si dhe a janë publikuar në platformën e financimit të OJQ-ve?

<b>Nr.</b>	<b>Indikatorët që vlerësojnë informacionet e raportuara për projektet/programet e mbështetura me fonde publike</b>
46.	Emërtimin e projektit/programit apo aktiviteteve të financuara
47.	Përfituesit e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë
48.	Fushat e përgjithshme dhe specifike të financimit

49.	Kohëzgjatjen e projektit dhe statusin e zbatimit të tij
50.	Thirrjen publike përmes të cilës është ofruar mbështetja financiare
51.	Emrin e plotë të përfituesve të mbështetjes financiare, duke përfshirë të dhënat tjera të përfituesit, adresën, numrin e regjistrimit, numrin fiskal dhe të dhënat për personin përgjegjës të OJQ-së
52.	Shumën e dhënë për financimin e projektit/programit
53.	Mënyrën e alokimit të mbështetjes financiare publike
54.	Të dhënat gjeografike sa i përket vendit të implementimit të projektit
55.	Emrin e ofruesit të mbështetjes financiare publike, duke përfshirë programet specifike në kuadër të të cilave ofrohet mbështetja financiare publike
56.	Numrin e përafërt të personave që kanë përfituar apo janë punësuar në kuadër të projekti/programit
57.	Aktivitetet kryesore të realizuara në kuadër të projektit
58.	Raportimi a është bërë sipas formularit përkatës, i cili duhet të plotësohet nga secili ofrues i mbështetjes financiare publike

<b>Nr.</b>	<b>Indikatorët që vlerësojnë informacionet e raportuara për projektet/programet e mbështetura me fonde publike</b>
59.	Ofruesi i mbështetjes financiare publike pasi ka përgatitur raportin vjetor, a i ka dërguar një kopje elektronike të raportit Zyrës së Kryeministrit, përkatësisht zyrës përkatëse për qeverisje të mirë, më së largu deri më 1 mars?
60.	Zyra e Kryeministrit/Zyra për Qeverisje të Mirë, mbi bazën e raporteve të pranuar nga secili ofrues i mbështetjes financiare publike, a e ka përgatitur raportin e përgjithshëm vjetor të mbështetjes financiare publike për OJQ-të, më së largu deri më 31 mars?
61.	A janë publikuar listat dhe shumat e organizatave përfituese në platformën e financimit publik të OJQ-ve, nga ofruesi i mbështetjes financiare?
62.	Raportimi a është bërë sipas formularit përkatës, i cili duhet të plotësohet nga secili ofrues i mbështetjes financiare publike.



**KOSOVO LOCAL  
GOVERNMENT  
INSTITUTE**

**Kosovo Local Government Institute**

**Address: Str. Egnatia, E-9, Fl-3, No. 17, 10000 Prishtina, Republic of Kosovo**

**Tel: +381 (0) 38 522 000**

**Mobile: +383 (0) 44 253 835**

**E-mail: [info@klgi-ks.com](mailto:info@klgi-ks.com) | web: [www.klgi-ks.com](http://www.klgi-ks.com)**